

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Raporti Paraprak

Tetor, 2025

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJE E PROCESIT TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM)	6
1.1 Qëllimi dhe kuadri ligjor i këtij dokumenti	6
Qëllimi i këtij dokumenti	6
1.2 Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Autoriteti Kompetent Përkatës	6
1.3 Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për PVMIM	8
1.3.1 Përfitimet e pritshme të një VSM-së	8
1.3.2 Pozicionimi i VSM-së në Hierarkinë Vendimmarrëse	8
1.3.3 Rëndësia e VSM-së në Planet e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve	9
2.1 Përkufizimi dhe përbërja e MNB në kuptimin e Planit	13
2.2 Gjendja Institucionale	14
2.2.1 Kuadri ligjor dhe institucional qendror i shërbimit	14
2.2.2 Organizimi institucional i shërbimit në bashki	18
3. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR	19
3.1 Fazat kryesore në procesin e VSM-së	19
Njoftimi i Ministrisë dhe fazat e shqyrtimit	20
Faza e Konsultimit	20
Identifikimi i Objektivave Strategjike Mjedisor	20
Përgatitja e Raportit Paraprak të VSM	25
Vështrim i përgjithshëm dhe rezultatet	25
Kapitulli 5 - Plani i Vlerësimit Strategjik Mjedisor Specifik	26
Kapitulli 6 - Vlerësimi Strategjik Mjedisor Ndërsektorial	26
Kapitulli 7 - Monitorimi dhe Raportimi	27
Kapitulli 8 – Veprimet strategjike me përparësi të rekomanduara	27
Procedurat e Konsultimit	27
Legjislacioni përkatës i BE-së dhe ai Kombëtar	28
Procesi i konsultimit	29
Përgatitja e Raportit Përfundimtar të VSM-së	30
4. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I BASHKISË	31
4.1 Të dhëna gjeografike	31
4.2 Të dhëna administrative	33
4.3 Gjendja e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	35
4.3.1 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve	36
4.3.2 Përmbledhje e gjetjeve kryesore të gjendjes fillestare	37
5. PLANI I VLERËSIMIT SPECIFIK STRATEGJIK MJEDISOR	44

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

5.1	Objektivat për Mbrojtjen e Mjedisit.....	44
	Programet dhe legjislacioni gjithëpërfshirës në nivel BE dhe kombëtar	44
	Legjislacioni Kombëtar Primar dhe Dytësor për Menaxhimin e Mbetjeve.....	46
	Ndërveprimet dhe Përputhshmëria me Objektivat Mjedisore.....	51
	Pasojat e mungesës së planit – “Alternativa Zero”	53
6.	VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR NDËRSEKTORIAL	56
	Objektivat e Vlerësimit Ndërsektorial të Mbrojtjes së Mjedisit	56
	Objektivi 1 – Identifikimi i Sektorëve të Jashtëm me Detyrime Potenciale sipas PVMIM-së.....	56
	Objektivi 2 – Identifikimi i Strategjive të Jashtme Sektoriale që Paraqesin Kërcënim për Objektivat e PVMIM.....	57
	Metodologjia e Vlerësimit.....	59
	Identifikimi i nevojës për konsultim.....	59
	Shqyrtimi i Strategjive të Jashtme	59
	Ndikimi Sektorial dhe Procedura e Vlerësimit	60
	Interpretimi i rezultatit të ndikimit.....	62
	Përpilimi i Ndikimeve Sektoriale kundrejt Objektivate Mjedisore	62
	Strategjitë Ndërsektoriale të Zhvillimit, Investimeve dhe Mbrojtjes së Mjedisit	67
	Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së.....	67
	Vlerësimi i Ndikimit Sektorial.....	67
	Planifikimi dhe Zhvillimi Urban	71
	Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së.....	71
	Vlerësimi i Ndikimit Sektorial.....	72
	Menaxhimi i mbetjeve të ngurta	75
	Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së.....	75
	Vlerësimi i Ndikimit Sektorial.....	75
	Zhvillimi bregdetar dhe Turizmi	77
	Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së.....	77
	Vlerësimi i Ndikimit Sektorial.....	77
	Infrastruktura e Transportit	79
	Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së.....	79
	Vlerësimi i Ndikimit Sektorial.....	79
	Bujqësi dhe Pylltari	82
	Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së.....	82
	Vlerësimi i Ndikimit Sektorial.....	82
	Industri, Miniera dhe Gurore	85

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së.....	85
Vlerësimi i Ndikimit Sektorial.....	85
Prodhim i Energjisë	87
Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së.....	87
Vlerësimi i Ndikimit Sektorial.....	88
Ujësjiellësi Publik	90
Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM.....	90
Vlerësimi i Ndikimit Sektorial.....	90
Ujërat e Ndotura Urbane	92
Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së.....	92
Vlerësimi i Ndikimit Sektorial.....	93
Ujërat e Ndotura Industriale	95
Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM.....	95
Vlerësimi i Ndikimit Sektorial.....	95
Menaxhimi i rrezikut nga përmytjet	97
Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së.....	97
Vlerësimi i Ndikimit Sektorial.....	97
Përmbledhje e Konsoliduar e Ndikimeve Sektoriale.....	99
Ndikimi më i lartë sipas sektorëve	99
Ndikimi më i lartë sipas komponentit.....	99
7. PROCEDURAT E MONITORIMIT, RAPORTIMIT DHE VERIFIKIMIT	101
7.1 Përputhshmëria Legjislative	101
7.1.1 Niveli Kombëtar – Ligji 91/2013 dhe Ligji 111/2012	102
7.1.2 Niveli i BE-së – Direktiva 2001/42/EC.....	102
7.1.3 Niveli i BE-së – Korniza e 8-të e Monitorimit të PVM-së	102
8. VEPRIMET STRATEGJIKE ME PËRPARËSI TË REKOMANDUARA (VSP)	109
8.1 Vështrim i përgjithshëm	109
8.2 Veprimet Strategjike me Përparësi	110
9. INFORMACION MBI PROCEDURËN E KONSULTIMIT PUBLIK	113
9.1 KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT PËR ÇËSHTJET QË DO TË TRAJTOHEN NË RAPORTIN E VSM-SË.....	113

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Lista e tabelave

Tabela 3-1– Elementet kryesore të procesit të VSM-së	19
Tabela 3-2 – Identifikimi i Objektivave Strategjike Mjedisore (OSM) dhe çështjeve të ndërlidhura ...	21
Tabela 3-3– Rezultatet e Konsultimit Gjithëpërfshirës	30
Tabela 4-1: <i>Të dhëna administrative Bashkia Durrës</i>	35
Tabela 4-2: <i>Të dhëna mbi ofrimin e shërbimit</i>	36
Tabela 6-1– Përmbledhje e politikave, planeve ose strategjive përkatëse ndërsektoriale	64
Tabela 6-2– Strategjitë Ndërsektoriale të Zhvillimit, Investimeve dhe Mbrojtjes së Mjedisit	70
Tabela6-3– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit Urban	74
Tabela6-4– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta	76
Tabela6-5– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Zhvillimi Bregdetar & Turizmi	78
Tabela6-6– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Sektori i Infrastrukturës së Transportit.....	81
Tabela6-7– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Sektori i Bujqësisë dhe Pylltarisë	84
Tabela6-8– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Sektori i Minierave dhe Gurorëve.....	86
Tabela6-9– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Sektori i Prodhimit të Energjisë	89
Tabela6-10– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Sektori i Ujësjetësimit Publik	91
Tabela6-11– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Sektori i Ujërave të Ndotura Urbane	94
Tabela6-12– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Sektori i Ujërave të Ndotura Industriale	96
Tabela6-13– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Sektori i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmblytjet.....	98
Tabela6-14– Vlerësimi i Objektivave Strategjike të PVMIM kundrejt ndërveprimeve sektoriale	100

Lista e figurave

Figura 1-I: Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve dhe objektet ekzistuese.....	16
Figura 4-I:Harta e pozicionimit të Bashkisë Durrës.....	32
Figura 4-II: Harta e ndarjes administrative e Bashkisë Durrës.....	34
Figura7-1– Arkitektura e Kornizës së 8-të të Monitorimit të PVM-së	103

1. PËRMBLEDHJE E PROCESIT TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM)

1.1 Qëllimi dhe kuadri ligjor i këtij dokumenti

Qëllimi i këtij dokumenti

Ky dokument ("Raporti paraprak i Vlerësimit Strategjik Mjedisor") ("Raporti i VSM") është pjesë përbërëse e dokumentacionit të përgjithshëm të lëshuar nga autoriteti propozues (Bashkia Durrës) që përgatit Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM) dhe që do i referohemi "Planit".

Kërkesa për aplikimin e një Vlerësimi Strategjik Mjedisor për një plan apo program të veçantë madhor është përcaktuar në legjislacionin shqiptar, (ligjit 91/2013). Ky ligj transponon gjerësisht kërkesat e Direktivës së BE-së 2001/42/EC ("Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor").

Drafti i Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM) të Bashkisë Durrës kaloi në fazën e dytë të konsultimit me publikun në x.x.2025, ai u publikua në faqen e internetit të Bashkisë Durrës për x muaj dhe kjo fazë përfundoi në x.2025. Raporti i plotë i PVMIM dhe ky Raport Paraprak i VSM-së duhet të lexohen së bashku.

Në përgjithësi, qëllimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të "Planit" është të sigurojë nivele të larta të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet shqyrtimit aktiv dhe konsultimit mbi çështjet mjedisore që mund të ndikohen negativisht nga zbatimi i Planit pa masat e duhura zbutëse.

1.2 Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Autoriteti Kompetent Përkatës

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor; PVMIM është njëherazi një dokument udhërrëfyes i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkiake (MNB) në Bashkinë Durrës. Plani mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor dhe rajonal. Plani është i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me operacionalizimin e sistemit të grumbullimit, reduktimit, trajtimit, depozitimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Ligji 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" përcakton përgjegjësitë dhe autoritetin e njësive të qeverisjes vendore. Në mënyrë të veçantë, sipas këtij përcaktimi, bashkitë kanë të drejtën dhe përgjegjësitë për:

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

- Organizimin për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, transportimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane;
- Ndërtimin, pronësinë dhe operimin e objekteve të trajtimit të mbetjeve;
- Vendosjen e tarifave të shërbimit për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimit dhe mbledhja e të ardhurave;
- Organizimin dhe shpërndarjen e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në vete dhe/ose në bashkëpunim me një ose më shumë bashki të tjera, duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore dhe administrative, duke përfshirë, por pa u kufizuar, me:
 - a) Një strukturë administrative buxhetore si pjesë e strukturës organizative të bashkisë;
 - b) Person juridik publik buxhetor bashkiak;
 - c) Njësia publike bashkiake e pavarur.

Referuar Nenit 10 (të cituar më poshtë) të Ligjit 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, autoriteti kompetent për hartimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve është Bashkia Durrës:

“Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisht të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.”

Deri në momentin e tanishëm, në Bashkinë Durrës menaxhimi i integruar i mbetjeve është realizuar bazuar në dokumentin “Rregullore për administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimit të qytetit Durrës”, të miratuar me Vendimin nr. 41, datë 09.05.2022 të Këshillit Bashkiak Durrës.

Në përgjithësi, dispozitat e ligjit 10463/2011, të ndryshuar, transpozojnë kërkesat e Direktivës së Bashkimit Evropian (BE) 2008/98/EC (amenduar në 2024), e njohur zakonisht si "Direktiva Kuadër e Mbetjeve" (DKM), një nga instrumentet rregullatore më të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit.

Gjithashtu, së fundmi është miratuar dhe projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Ky projektligj i miratuar nga qeveria pritet të nisë shqyrtimin edhe në Kuvend. Ai synon gjithashtu të marrë përsipër dhe të përafrojë direktivat e BE-së 100% me legjislacionin shqiptar.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

1.3 Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për PVMIM

1.3.1 Përfitimet e pritshme të një VSM-së

Qëllimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) i aplikuar për një plan ose program madhor kombëtar ose rajonal që mund të ketë efekte të rëndësishme në të ardhmen në mjedis, është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të kontribuojë në integrimin e masave mjedisore. Përgatitja dhe miratimi i planeve dhe programeve të tilla nxit zhvillimin e qëndrueshëm në planin afatgjatë.

Ndërmarrja e një VSM-je paralelisht me zhvillimin e strategjisë ose planit të synuar (në këtë rast Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve) siguron që të ketë një proces të qartë dhe transparent për angazhimin e palëve të interesuara dhe publikut brenda procesit të zhvillimit të Planit. Gjithashtu, siguron që të përfshihen komentet dhe sugjerimet e tyre duke synuar marrjen e vendimeve dhe rezultateve më të qëndrueshme.

Një VSM informative dhe e dobishme e aplikuar për një plan specifik duhet të sigurojë një bazë të strukturuar provash (të dhëna, informacion të publikuar, modelim dhe/ose konsultime me ekspertë) për të demonstruar se si integrimi i çështjeve mjedisore (përfshirë efektet e ndryshimeve klimatike) brenda planit të propozuar do të përmirësojë në mënyrë aktive. Qëndrueshmëri afatgjatë mjedisore dhe ekonomike.

1.3.2 Pozicionimi i VSM-së në Hierarkinë Vendimmarrëse

Ndërsa vendimmarrja orientohet nga politika në projekte (gjithnjë e më specifike) natyra e vendimmarrjes ndryshon, ashtu si dhe natyra e vlerësimit mjedisor që nevojitet. Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM) janë të ndryshme nga Vlerësimet Strategjike Mjedisore dhe metodologjia që do të zbatohet është gjithashtu e ndryshme.

Vlerësimi në nivel projekti zakonisht ka specifikime të mirëpërcaktuara dhe të përshkruara që adresohen përmes Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) specifike të skemës. Në Shqipëri, këto vlerësime në nivel projekti mbulohen nga VKM 912/2015.

Anasjelltas, vlerësimi në nivel politikash duhet të trajtojë një shkallë më të gjerë konsultimi p.sh. në shkallën e Bashkisë Durrës, ku aplikohet një qasje më fleksibël, trajton një gamë më të gjerë palësh të interesuara, skenarë dhe çështje në afat të gjatë dhe merr parasysh efektet ose ndikimet akumuluese (d.m.th. masat strategjike).

Prandaj, ekziston një ndryshim thelbësor midis Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)¹.

¹ ORGANIZATA PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM EKONOMIK - Zbatimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor - UDHËZUES PËR PRAKTIKA TË MIRA PËR BASHKËPUNIM ZHVILLIMOR. Udhëzimet e OECD DAC dhe seritë e referencës 2006.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës




Figura 1-1 - Hierarkia Vendimmarrëse

Burimi : OECD, 2006²

1.3.3 Rëndësia e VSM-së në Planet e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Interpretimi i Ligjit Shqiptar 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” (dhe Direktivës së BE-së 2001/42/KE) është se plani ose programi specifik që po hartohet (në këtë rast PVMIM i Bashkisë Durrës) ka të ngjarë të ketë ndikime negative mjedisore në rast se nuk kryhet konsultimi, koordinimi dhe zbutja e duhur e ndikimeve mjedisore me palët e interesuara. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për sektorët ekonomikë si zhvillimi urban, furnizimi me ujë dhe ujërat e zeza, bujqësia, prodhimi i energjisë, transporti dhe infrastruktura, zhvillimi bregdetar dhe turizmi.

Megjithatë, disa plane ose strategji sektoriale (si p.sh. PVMIM-të që zbatojnë Direktivën Kuadër të Mbetjeve) janë nga natyra e tyre kryesisht “mjedisore pozitive” sepse objektivi kryesor i vetë Planit është mbrojtja dhe qëndrueshmëria e mjedisit. Pavarësisht nga ky dyfishim i qëllimit, rregulloret e VSM-së mund të konsiderohen ende të rëndësishme për PVMIM sepse ato janë a) duke u përgatitur dhe miratuar nga një autoritet rregullator kombëtar b) ato potencialisht vendosin kuadrin për miratimin e ardhshëm të zhvillimit të projekteve të tjera sektoriale në menaxhimin e ujit.

Kjo pikë e fundit është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin strategjik. Qëllimi kryesor i VSM të PVMIM është të përcaktojë “Objektivat Mjedisore” (OM) për menaxhimin e mbetjeve në territorin që ky plan mbulon. Këta objektiva mjedisorë duhet të respektohen nga të gjitha programet dhe planet e tjera sektoriale dhe për këtë arsye PVMIM ka një rol qendror “strategjik” në përcaktimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të mjedisit në përgjithësi.

² Zbatimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor - UDHËZUES PËR PRAKTIKA TË MIRA PËR BASHKËPUNIM PËR ZHVILLIM, OECD 2006

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Në mënyrë tipike, edhe në shkallën vendore të Bashkisë Durrës, produkti kryesor i “programit të masave” duhet të zbatohet në mënyrë shumë specifike për mjedisin në tërësi ose komponentë individuale, edhe nëse masat përfshijnë p.sh. përmirësime të përgjithshme ligjore dhe rregullatore, ndryshime operacionale ose zgjidhje teknike (psh. objekte të menaxhimit të mbetjeve). Në shumë raste, Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) do të duhet të zbatohet për objektet e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve (shih Figurën 1-1).

Anasjelltas, Vlerësimi Strategjik Mjedisor nuk duhet të fokusohet në nivelin e objekteve të infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve. Përkundrazi, ai duhet të jetë një proces i vazhdueshëm, periodik dhe i përshtatur në një qeverisje më të mirë dhe veçanërisht në forcimin e koordinimit ndërmjet institucioneve dhe sektorëve ekonomikë, në mënyrë që të sigurohen rezultatet më të mira afatgjata (mjedisore) për vetë Planin, programet, planet e tjera sektoriale dhe politikat që mund të rregullohen prej tij.

Lidhur me PVMIM, ky interpretim i rëndësisë së VSM-së dikton dy objektiva kryesore për vijimin e procesit:

- 1- Të shqyrtojë objektivat e Planit (të përcaktuara në PVMIM si “masa”), të vlerësojë nëse Planit ka të ngjarë të sjellë ose jo pasoja negative mjedisore (pa zbutje) dhe, nëse po, të identifikojë veprime alternative ose lehtësuese për të kompensuar pasoja negative.

Duhet të pritët gjerësisht që ndikimet mjedisore dhe rezultatet nga një plan i menaxhimit të mbetjeve duhet të jenë përgjithësisht pozitive dhe për këtë arsye nuk ka gjasa që të kërkojnë zgjidhje alternative dhe/ose zbutëse për shumicën e masave të propozuara, pasi masat në përgjithësi, orientojnë drejtpërdrejt në mjedis, pra kanë si qëllim përmirësimin e statusit aktual të menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë Durrës.

Megjithatë, mund të ndodhë që mbeten çështje të rëndësishme mjedisore të identifikuar si pjesë e procesit të VSM-së, të cilat, sipas palëve të interesuara, nuk janë adresuar në mënyrë të përshtatshme (d.m.th. ose ka mungesa të çështjeve më rëndësi ose nuk janë trajtuar siç duhet) nga programi i masave dhe këto dobësi të mundshme duhet gjithashtu të identifikohen nga procesi i VSM-së.

Ky rezultat është fokusi i Kapitullit 5 – Planit i Vlerësimit Strategjik Mjedisor Specifik.

Meqenëse PVMIM zbatohen në nivel bashkiak, është e vetëkuptueshme që shumë kërkesa legislative, strategji, sektorë, operatorë, grupe interesi dhe aktorë të tjerë ndërsektorial kanë të ngjarë të ndikohen nga propozimet e Planit (“masa”). Edhe nëse masat e PVMIM pritët të jenë përgjithësisht pozitive, duhet të identifikohen dhe vlerësohen ndikimet afatgjata rregullatore ose operacionale mbi aktorët e tjerë të mundshëm që rrjedhin nga PVMIM.

Për shembull, masat e PVMIM mund të përfshijnë ndryshime rregullatore ose operacionale që imponojnë detyrime ose kosto të reja në sektorë të tjerë. Nëse këto ndryshime nuk kuptohen plotësisht, nuk mund të zbatohen ligjërisht, rrjedhimisht, nuk pranohen ose

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

buxhetohen nga sektori i prekur. Kjo përbën një rrezik të dështimit të PVMIM dhe objektivave të tij për mbrojtjen e mjedisit.

Teorikisht, masat e propozuara në projekt-dokumentin e planit që prekin sektorët e jashtëm duhet të ishin konsultuar më parë dhe të ishin rënë dakord në parim përmes procedurave të konsultimit të PVMIM, por ato janë zakonisht dokumente shumë komplekse dhe teknike, dhe si të tillë ndërveprimet dhe implikimet për sektorët e jashtëm ekonomik dhe palët e tjera të interesuara nuk janë gjithmonë të dukshme.

- 2- Raporti i VSM-së paralelisht me Raportin e PVMIM duhet të ofrojë një vlerësim më të gjerë, të integruar dhe afatgjatë (d.m.th. strategjik) të rrezikut të këtyre konflikteve ose rreziqeve të mundshme dhe një mundësi të dytë për palët e interesuara që të kuptojnë implikimet e masave të PVMIM në sektorin e tyre përkatës. Me fjalë të thjeshta: “cilat janë mundësitë ose kërcënimet për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim zbatimin e suksesshëm të Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Durrës të ndërlidhura me sektorët e jashtëm që zbatojnë politikat apo strategjitë apo programet e tyre”?

Si rrjedhim, sektorët e jashtëm që propozojnë politika ose strategji që bien ndesh ose nuk mbështesin objektivat mjedisore të përcaktuara në planet e menaxhimit të integruar të mbetjeve kombëtare kanë të ngjarë të hasin rezistencë të konsiderueshme nga institucionet që kanë në fokus të tyre mjedisin.

Ky rezultat është kryesisht fokusi i Kapitullit 6 – Vlerësimi Strategjik Mjedisor Ndërsektorial.

2. PËRSHKRIMI I QËLLIMIT DHE OBJEKTIVAVE KRYESORE TË PLANIT OSE PROGRAMIT

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor; PVMIM është njëherazi një dokument udhërrëfyes i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkaie (MNB) në Bashkinë Durrës. Plani mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor dhe rajonal. Plani është i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me operacionalizimin e sistemit të grumbullimit, reduktimit, trajtimit, depozitimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Qëllimi i PVMIM konsiston në adresimin e sfidës që ka bashkia për të ofruar shërbim me cilësi dhe standard në të gjithë territorin e saj, duke optimizuar koston e shërbimit kundrejt disponibilitetit financiar që ka bashkia dhe hartimin e nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Procesi do të kalojë në disa hapa ku grupi i punës do të organizoi seanca diskutimi me ekspertë të bashkisë dhe dëgjesa me përfaqësues të komunitetit për të zhvilluar një proces gjithëpërfshirës gjatë hartimit të planit dhe për të arritur në një dokument përfundimtar i cili ka marrë në konsideratë nevojat e grupeve të interesit.

Përse Hartohet Plani

Plani ka për qëllim që t'i japë Bashkisë Durrës një instrument solid që do të sigurojë menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkiake në:

- Përputhshmëri me Dokumentin e Politikave Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Planin Kombëtar 2020–2035”³ (Dokumenti i Politikave Strategjike) dhe “Plani Sektorial Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”⁴ (Plani Sektorial) dhe objektivat e tyre: duke kontribuar në zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve;
- Përmbylljen e opsioneve më të mira të mundshme për grumbullimin dhe transportin e MNB duke marrë në konsideratë infrastrukturën vendore dhe rajonale siç është propozuar Planin Sektorial;
- Përmbylljen e opsioneve të reduktimit të mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare;

³ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 27.05.2020

⁴ Miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendimin Nr. 1 datë 13.01.2020

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

- Mundësimin e plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe masat për rregullimin e shërbimit në kufijtë e bashkisë për të siguruar përputhshmërinë me standardet e Menaxhimit të mbetjeve;
- Përmbytjen e nevojave financiare operacionale dhe investimeve kapitale për zbatimin e skemave të grumbullimit, transportit dhe trajtimit të mbetjeve.

2.1 Përkufizimi dhe përbërja e MNB në kuptimin e Planit

Mbetjet e Ngurta Bashkiake përfshijnë mbetje shtëpiake dhe mbetje të ngjashme. Ato gjithashtu përfshijnë:

- Mbetje voluminoze (psh mbetjet e bardha ose elektro-shtëpiake, mobilje të vjetra dysheke etj): dhe
- Mbetjet e kopshteve, gjethe, barishte mbetjet nga fshirja e rrugeve, përmbajtjen e konteinereve me mbetje nga kafshët shtëpiake, dhe mbetjet e pastrimit të marketeve.

Për nga mënyra e menaxhimit.

Ato përmbajnë mbetje që gjenerohen nga:

- familjet,
- aktiviteti tregtar, bizneset e vogla, zyra dhe institucionet (shkolla spitale (përfshijë mbetjet spitalore) dhe ndërtesat qeveritare) .

Ato përfshijnë gjithashtu, kur ato menaxhohen si mbetje:

- mbetjet nga shpërbime të veçanta të bashkive si psh: mbetje nga parqet, mbetjet nga pastrimi i rrugeve.

Ato përmbajnë mbetje nga burimet e grumbullimit :

- grumbullimi tradicional derë më derë (mbetje shtëpiake të përzjera), dhe
- fraksione të cilat mbledhen të ndara për operacione rikuperimi (nëpërmjet sistemit derë më derë dhe/ose sistemit të depozitimit vullnetar) dhe që përbëhen kryesisht nga 4 rryma: leter/karton; plastikë; metale; dhe qelq.

Përkufizimi përfshin gjithashtu mbetje nga të njëjtat burime dhe të ngjashme në natyrë të cilat përbëhen nga mbetje të cilat grumbullohen prej:

- direkt nga sektori privat jo domosdoshmërisht në emer të bashkisë të cilat përdoren kryesisht për qëllimin e rikuperimit;
- që gjenerohen nga zonat rurale të cilat nuk shërbejnë nga një shërbim i rregullt, edhe kur ato hidhen nga ai që i gjeneron.

Përkufizimi përjashton:

- *mbetjet nga trajtimi i ujrave të përdorura,*
- *mbetjet nga ndërtimi dhe prishjet (inerte).*

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Plani ka për subjekt menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Bashkia (MNB) përfshirë ato shtëpiake dhe të ngjashme që gjenerohen nga subjekte të tjera të cilat mblidhen nga bashkia dhe/ose në emër të bashkisë nga të tretë, përfshirë edhe ato mbetje të cilat mund të mblidhen nga subjekte private për qëllimin e rikuperimit⁵.

2.2 Gjendja Institucionale

2.2.1 Kuadri ligjor dhe institucional qendror i shërbimit

Menaxhimi i MNB është një funksion qeverisjeje, zbatimi i të cilit ngarkon një numër institucionesh qendrore dhe vendore, përfshirë edhe gjeneruesit e mbetjeve. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta bashkiake në veçanti, si njëra prej rrymave të mbetjeve, është përcaktuar si një funksion i njësisë të vet-qeverisjes vendore, bashkive.

Menaxhimi i MNB është një përgjegjësi e cila implikon edhe gjeneruesit e tyre siç mund të jenë tregtare, restorante, zyra, institucione shtetërore etj., mbetjet e të cilëve janë të ngjashme me ato të gjeneruara në familje. Përformanca e çdo njësie familjare dhe gjeneruesi tjetër do të ndikojë në rezultate pozitive për afrimin drejt një modeli të qendrueshëm të menaxhimit të mbetjeve, i cili do të ulë ndjeshëm sasinë e mbetjeve të cilat përfundojnë në depozitimin final, duke ndikuar edhe në uljen e kostove të transportit.

Dokumenta strategjik

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka miratura në 2020 dy dokumenta kryesor strategjik për sektorin e mbetjeve në vend “Dokumenti i Politikave Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar 2020-2035” dhe “Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, të cilët përcakton objektivat strategjike, synimet dhe infrastrukturën kryesore të nevojshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Këto dokumente shënojnë një moment të rëndësishëm në përmirësimin e sektorit, por ato duhet të ndiqen nga plane zonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve dhe investimeve për ndërtimin e infrastrukturës të magazinimit të përkohshëm (stacionet e transferimit) dhe lëndfilleve sanitare në mënyrë që të arrihet një gjendje e mirë mjedisore.

Dokumenti i Politikave Strategjike merr në konsideratë zhvillimet e planifikimit dhe infrastrukturës në sektorin e mbetjeve, si në nivelin e qeverisjes qendrore dhe vendore, përfshirjen e konsiderueshme të biznesit privat dhe investime të shumta të ndërmarra në nivelin e grumbullimit, transferimit dhe veçanërisht trajtimit të mbetjeve. Dokumenti i rishikuar i Politikave Strategjike është zhvilluar mbi vizionin ose parimin e konceptit „zero mbetje“, në mënyrë që mbetjet të grumbullohen dhe trajtohen si lëndë e parë dhe menaxhimi të bëhet në përputhje me konceptin dhe parimet e sistemit të ekonomisë qarkulluese. Qëllimi kryesor i Dokumentit të Politikave Strategjike është të sigurojë udhëzime strategjike.

⁵ Ky trajtim harmonizon mënyrën se si mbetjet subjekt i planeve vendore janë përkufizuar respektivisht në ligjin 139/2015 dhe 10 463/2011 duke marrë në konsideratë konceptin e mbetjeve të ngurta bashkiake nga EUROSTAT/OSBE dhe Direktiva Kuader 2008/98/KE dhe Direktivën për Landfill-et (1999 EU)

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Objektivat specifike të Dokumentit të Politikave Strategjike kanë si qëllim të ofrojnë zgjidhje praktike për:

- Adresimin e problemeve të sistemit të menaxhimit.
- Zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi.
- Përmbylljen e detyrimeve specifike të legjislacionit të BE-së për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë objektivat ambiciozë të Paketës së ekonomisë qarkulluese.

Arritja e këtyre objektivave përmirëson cilësinë e mjedisit dhe shëndetin e qytetarëve, duke i dhënë një shtysë tjetër zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, si dhe duke hapur rrugën drejt integritetit evropian.

Dokumenti i Politikave Strategjike, i cili është niveli më i lartë i planifikimit në fushën e menaxhimit të mbetjeve, është një dokument veprimi për të ardhmen, ku bazohen strategjitë dhe planet, dhe rregullohen ndërveprimet dhe burimet. Ky dokument është në përdorim për: politikëbërësit, për të drejtuar procesin e tyre të vendimmarrjes në lidhje me menaxhimin e mirë të mbetjeve; përcakton objektiva të vërtetë strategjike dhe synime të arritshme që synojnë të arrijnë nivelet e përcaktuara nga direktiva e BE-së në drejtim të planifikimit horizontal.

Plani Sektorial përfaqëson dokumentin e nivelit të dytë të planifikimit për menaxhimin e mbetjeve, i cili përcakton kuadrin e planifikimit në lidhje me investimet kombëtare dhe rajonale të infrastrukturës, zgjedhja e vendeve për vendosjen e infrastrukturës dhe alokimi i investimeve për infrastrukturën përkatëse. Ky dokument ndan vendin, për qëllimet e menaxhimit të mbetjeve, në “10 zona të menaxhimit të mbetjeve”, të cilat marrin parasysh infrastrukturën aktuale të menaxhimit të mbetjeve, tipologjinë e terrenit, afërsinë dhe përballimin e kostos nga bashkitë. Ky dokument u shërben autoriteteve përgjegjëse për të identifikuar dhe përcaktuar metodologjinë dhe teknologjinë për investimet e ardhshme në trajtimin e mbetjeve, duke përfshirë pajisjet për grumbullimin e mbetjeve, kompostimin, riciklimin, djegien për gjenerimin e energjisë dhe bazën e depozitimit; gjithashtu shërben si bazë për planifikimin në nivelin e zonave të menaxhimit të mbetjeve, deri në nivelin e planeve bashkiake.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës




Figura 1-I: Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve dhe objektet ekzistuese

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Legjislacioni kryesor

Aktualisht, ligji 10,463 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"⁶, i amenduar, është legji bazë që përcakton përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe vendore në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Ky ligj shoqërohet edhe nga akte të tjera ligjore të cilat janë hartuar më vonë për ta bërë ligjin të zbatueshëm duke i ndarë përgjegjësi të detajuara për ministritë e linjës në varësi të kategorisë së mbetjeve.

Në Shtator të 2024 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka shpalluar për konsultim publik ligjin e ri për menaxhimin e integruar të mbetjeve i cili parashikon disa ndryshime në raport me ligjin aktual për t'ju përshtatur edhe dokumentave strategjik. Në këtë drejtim, referuar Dokumentit të Politikave Strategjike, vendi është ndarë në 10 zona mbetjesh, ku një zonë mbetjesh është e përbërë nga disa bashki. Ligji i ri parashikon rritjen e bashkëpunimit ndërvendor ndërmjet bashkive përbërëse të një zone mbetjesh, për rritjen e standardit dhe eficientimit të ofrimit të shërbimit, të cilat rregullojnë marrdhënien nëpërmjet nënshkrimit të një marrveshje bashkëpunim ndërvendor⁷ ku ndër të tjera kanë detyrimin e hartimit të një plani zonal i cili do të adresojë menaxhimin e mbetjeve në atë zonë. Ligji i ri gjithashtu kalon kompetencat për infrastrukturën kombëtare të mbetjeve nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës tek Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, element ky që bënë të mundur që MTE të jetë institucioni përgjegjës për të gjithë elementët e sektorit të menaxhimit të mbetjeve.

- Ministria përgjegjëse për mjedisin

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, MTM është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe aspekteve të përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve. Në bashkëpunim me institucione të tjera, MTM është institucioni përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave, legjislacionit, infrastrukturës së trajtimit të mbetjeve, hartimit dhe zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Menaxhimin e Mbetjeve. Së bashku me institucionet e tjera vartëse, duke përfshirë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve. Ministria ka përgjegjësinë e plotë për krijimin dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të menaxhimit të mbetjeve në nivel zonal dhe vendor.

- Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve

Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, AKEM, është institucion publik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin, e cila mundëson tranzicionin nga një qasje linare në atë qarkulluese në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. AKEM bashkërendon me institucione publike në nivel qendror dhe vendor, me partnerët ndërkombëtare dhe investitorë apo palë të tjera të interesuara, për planifikimin territorial të infrastrukturës së

⁶ Shënim: Në Shtator 2024 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka shpallur për konsultim publik ligjin e ri për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake i cili parashikon disa ndryshime në raport me ligjin e vjetër. Për qëllimin e këtij dokumenti si reference do të mbahet ligji i vjetër për arsye se ligji i ri nuk është miratuar ende e për rrjedhojë nuk mund të merret për referencë.

⁷ RNJEK_Projektligji 'Për menaxhimin e integruar të mbetjeve', Neni 26, Bashkëpunimi ndërvendor

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

mbetjeve dhe funksionimin e tyre në përputhje me parashikimet e këtij ligjil monitorimin e zbatimit të planeve në nivel qendraor e vendor; monitoron zbatimin për detyrimin për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve dhe rikuperimin e tyre si dhe koordinon me bashkitë iniciativa të cilat promovojnë aplikimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese.

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, AKM, është institucion publik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin. Në sektorin e menaxhimit të mbetjeve AKM ushtron kompetencat e saj në mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe analizimin e të dhënave për krijimin dhe trajtimin e mbetjeve të cilat lidhen me zbatimin e lejeve mjedisore. AKM gjithashtu organizon dhe menaxhon regjistrat e të dhënave që kanë të bëjnë me menxhimin e integruar të mbetjeve dhe vlerësimin e ndikimit mjedisor e licencimin e veprimtarive në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

2.2.2 Organizimi institucional i shërbimit në bashki

Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” përcakton përgjegjësitë dhe autoritetin e njësive të qeverisjes vendore. Në mënyrë të veçantë, . Sipas këtij përcaktimi, bashkitë kanë të drejtën dhe përgjegjësitë për:

- Organizimin për ofrimin i shërbimit të grumbullimit, transportimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane;
- Ndërtimin, pronësinë dhe operimin e objekteve të trajtimit të mbetjeve;
- Vendosjen e tarifave të shërbimit për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimit dhe mbledhja e të ardhurave;
- Organizimin dhe shpërndarjen e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në vete dhe/ose në bashkëpunim me një ose më shumë bashki të tjera, duke përdorur të gjithë instrumentet ligjore dhe administrative, duke përfshirë, por pa u kufizuar, me:
 - d) Një strukturë administrative buxhetore si pjesë e strukturës organizative të bashkisë;
 - e) Person juridik publik buxhetor bashkiak;
 - f) Njësia publike bashkiake e pavarur.

Këshilli Bashkiak: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të menaxhimit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave urbane për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike në nivel vendor si plane, plan-veprime, rregullore.

Policia e bashkiake është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me manaxhimin e mbetjeve.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

3. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR

3.1 Fazat kryesore në procesin e VSM-së

Fazat kryesore të procesit të VSM-së përcaktohen në Ligjin 91/2013, përkatësisht në nenet 8, 9, 10, 11 dhe 12. Këto janë përmbledhur në tabelën 3-1, së bashku me datat përkatëse.

Tabela 3-1– Elementet kryesore të procesit të VSM-së

Fazat e Përcaktuara 91/2013	OBJEKTIVAT
Njoftimi i Ministrisë dhe faza e shqyrtimit (Neni 8)	Vendimi nëse kërkohet një VSM për PVMIM dhe kriteret mbi të cilat duhet të bazohet Njoftimi për Ministrinë i lëshuar më 30.06.2025 Përgjigja nga Ministria është marrë më
Konsultimi (Neni 9)	Shtirja dhe përcaktimi i detajeve që duhet të merren parasysh për VSM-në Lista e palëve kryesore të interesuara dhe masat koordinuese Takimi konsultativ i përmbajtjes së VSM-së, i mbajtur më 10.07.2025
Përgatitja dhe finalizimi e Raportit Paraprak të VSM-së (Neni 10)	Përmbajtja e planit. Përkufizimi i Objektivave Strategjike Mjedisore (OSM). Vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme në mjedis që rrjedhin nga zbatimi i PoM të PVMIM dhe shqyrtimi i alternativave të arsyeshme. Vlerësimi i implikimeve ndërsektoriale të PVMIM, duke përfshirë mundësitë dhe kërcënimet e politikave, programeve dhe planeve të jashtme sektoriale. Kërkesë për komente dhe sugjerime nga palët e interesuara Draft Raporti paraprak i VSM-së duhet të shoqërojë draft PVMIM.
Periudha e konsultimit dhe seancës publike në përputhje me VKM nr. 2019, datë 11.03.2015	Publikimi i Raportit Paraprak të VSM-së në ... Tetor 2025. Njoftimi për palët e interesuara më ... Tetor 2025. Forumi i dëgjimit publik i mbajtur më në Periudha e konsultimit për Raportin Paraprak të VSM-së u mbyll më
Vlerësimi mjedisor, konsultimi, rishikimi dhe finalizimi i Raportit Përfundimtar të VSM-së (Neni 11)	Rishikimi dhe vlerësimi i përgjigjeve të konsultimit. Përcaktoni nëse Programi i Masave në PVMIM kërkon ndryshime ose plotësime. Arsyetime për përzgjedhjen përfundimtare të masave Raporti Përfundimtar i VSM-së duhet të shoqërojë Raportin Përfundimtar të PVMIM Raporti Përfundimtar i VSM i publikuar në
Deklarata e Pajtuashmërisë me VSM-në nga autoriteti kompetent (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit) (Neni 12)	Dhënia e një Deklarate për VSM-në nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit për të shoqëruar publikimin dhe miratimin e Raportit Përfundimtar të PVMIM-së. Deklarata e Përputhshmërisë së procesit të VSM-së marrë nga MTM në

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Njoftimi i Ministrisë dhe fazat e shqyrtimit

Referuar ligjit 91/2014 (neni 8), autoriteti propozues duhet të njoftojë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) për statusin dhe qëllimin e 'Planit' dhe MTM-ja duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve me një udhëzim për a) nëse kërkohet ose jo VSM. b) në bazë të kriterëve ndihmëse sipas Shtojcës I, do përcaktohen çështjet që do të përfshihen në raportin e VSM-së.

Njoftimi zyrtar i Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Durrës iu dha Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nga autoriteti i propozuar (Bashkia Durrës) më 30.06.2025.

MTM u përgjigj sipas pikave kryesore si më poshtë:

- mbrojtjen e natyrës dhe zonat e mbrojtura;
- mbrojtja e faunës, florës së egër dhe habitatet me rëndësi, si dhe llojeve endemike të specieve në territorin e Shqipërisë;
- menaxhimi i mbetjeve;
- ndotja e ujit;
- ndryshimet klimatike.

Faza e Konsultimit

Sipas ligjit 91/2013 (neni 9), pritet që autoriteti propozues, përpara se të fillojë hartimin e Raportit Paraprak të VSM-së, të konsultohet me palët e interesuara, përgjegjësitë e të cilëve mund të lidhen me planin ose programin, ku më pas kërkohet i duhet të dorëzojnë sugjerime për çështjet që do të trajtohen në Vlerësimin Strategjik Mjedisor, sipas rastit:

- institucionet që lidhen me mbrojtjen e shëndetit publik;
- njësitë e qeverisjes vendore;
- institucionet që lidhen me mbrojtjen e tokës bujqësore;
- organizata të njohura ligjërisht aktive në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- institucione të tjera që mund të jenë lidhura me vendimmarrjet mjedisore.

Veprimtaria e konsultimit u zyrtarizua më 10.07.2025, dhe u mbyll më 31 korrik 2025.

Identifikimi i Objektivave Strategjikë Mjedisor

Duhet marrë parasysh sfera e gjerë të “çështjeve mjedisore me rëndësi” të përmendur në Direktivën e BE-së 2001/42/BC⁸ dhe Ligjin 91/2013, neni 10, por edhe “çështjet” që sugjerojnë palët e interesuara të përmendura në 3.1.2, në mënyrë që të sigurohet një referencë e qëndrueshme kornizë për:

a) objektivat ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen së mjedisit;

⁸ DIREKTIVA 2001/42/BE Për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, Shtojca I

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

b) rëndësinë e PVMIM dhe si lidhet me këto objektiva;

c) ndikimet e sektorëve të jashtëm në këto objektiva;

d) procedurat e konsultimit.

Është përcaktuar një listë kryesore e OSM kryesore, të cilat përdoren gjatë pjesës së mbetur të Raportit të VSM-së. Këto SEO kanë të bëjnë vetëm me çështjet e menaxhimit të ujit. Këto janë përmbledhur në tabelën 3-2.

Tabela 3-2 – Identifikimi i Objektivave Strategjike Mjedisore (OSM) dhe çështjeve të ndërlidhura

Objektivat Strategjikë Mjedisore	Fusha Tematike	Çështjet me rëndësi ndërkombëtare dhe kombëtare
OSM1	Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike	• Çështjet me rëndësi ndërkombëtare - o Emetimet e gazrave serrë nga sektori i mbetjeve - o Zbatimi i Marrëveshjes së Parisit - o Përshtatja e infrastrukturës së mbetjeve ndaj fatkeqësive klimatike - o Financimi ndërkombëtar për menaxhimin e mbetjeve dhe klimën - o Përafrimi me direktivat e BE-së për mbetjet dhe klimën • Çështjet me rëndësi kombëtare - o Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike - o Rritja e rrezikut nga përmytjet dhe ndotja për shkak të menaxhimit të dobët të mbetjeve - o Mungesa e ndarjes në burim dhe kompostimit të mbetjeve organike - o Mungesa e planeve për menaxhim të mbetjeve në raste emergjencash klimatike - o Nevoja për investime në teknologji të gjelbra dhe infrastrukturë rezistente ndaj klimës
OSM2	Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore	• Çështjet me rëndësi ndërkombëtare - o Zbatimi i Direktivës Kuadër për Ujërat (2000/60/EC) - o Marrëveshja e Barcelonës për mbrojtjen e detit Mesdhe nga ndotja - o Ndotja ndërkufitare e ujërave nga mbetjet urbane dhe industriale - o Ndotja e deteve nga plastika dhe mikroplastika (iniciativa ndërkombëtare për ndalimin e tyre) - o Standardet e BE-së për trajtimin e ujërave të ndotura dhe mbetjeve në afërsi të ujërave sipërfaqësore • Çështjet me rëndësi kombëtare

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

		○ Ndotja e lumenjve, kanaleve dhe vijës bregdetare nga venddepozitimet informale dhe rrjedhjet e mbetjeve ○ Mungesa e impianteve të trajtimit të mbetjeve në zona të ndjeshme ujore ○ Pikat e grumbullimit të mbetjeve pranë lumenjve dhe detit ○ Rrjedhja e mbetjeve urbane dhe të ngurta në ujërat sipërfaqësore gjatë reshjeve intensive ○ Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Mbetjet Detare dhe Planit të Menaxhimit të Baseneve Ujore
OSM3	Mbrojtja e ujërave nëntokësore	• Çështjet me rëndësi ndërkombëtare ○ Zbatimi i Direktivës së BE-së për mbrojtjen e ujërave nëntokësore (2006/118/EC) ○ Marrëveshjet ndërkombëtare për mbrojtjen e burimeve të ujit nga ndotja antropogjene ○ Parandalimi i ndotjes së ujërave nëntokësore nga lendfillet dhe ujërat e ndotura (leksiviatet, shllami) ○ Monitorimi dhe ruajtja e cilësisë së ujit në kuadër të konventave ndërkombëtare për ndryshimet klimatike ○ Përafrimi me standardet e BE-së për monitorimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore • Çështjet me rëndësi kombëtare ○ Mungesa e mbrojtjes fizike të ujësjetllësave dhe puseve nga ndotja e mbetjeve ○ Vendosja e venddepozitimeve afër zonave të mbrojtura hidro-geologjikisht ○ Rreziku nga infiltrimi i ndotësve nga mbetjet në ujërat nëntokësore ○ Mungesa e impianteve për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme që mund të ndotin ujërat nëntokësore ○ Mungesa e monitorimit të rregullt të cilësisë së ujit nëntokësor në zonat urbane dhe rurale
OSM4	Cilësia e Ajrit	Çështjet me rëndësi ndërkombëtare ○ Zbatimi i Direktivave të BE-së për cilësinë e ajrit (Direktiva 2008/50/EC) ○ Marrëveshjet ndërkombëtare për reduktimin e ndotjes nga dioksidi i karbonit, pluhurat PM10 dhe PM2.5 ○ Lidhja mes menaxhimit të mbetjeve (djegia, dekompozimi) dhe emetimeve ndotëse në ajër ○ Reduktimi i ndotjes ajrore nga burime të qëndrueshme me efekte ndërkufitare ○ Zbatimi i Marrëveshjes së Parisit për reduktimin e emetimeve nga sektorët mjedisorë Çështjet me rëndësi kombëtare ○ Djegia e mbetjeve në mënyrë të pakontrolluar në ambiente të hapura

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

		○ Venddepozitimet që emetojnë gazra të dëmshëm për ajrin dhe shëndetin publik ○ Ndotja e ajrit në zonat urbane për shkak të mungesës së sistemit të mbledhjes së mbetjeve ○ Mungesa e sistemit të filtrimit dhe monitorimit të ndotjes nga sektorët e trajtimit të mbetjeve ○ Mungesa e të dhënave të vazhdueshme për cilësinë e ajrit në nivel vendor
OSM5	Shëndeti Publik	Çështjet me rëndësi ndërkombëtare ○ Udhëzimet e OBSH për ndikimin e mbetjeve në shëndetin publik ○ Zbatimi i Konventës së Minamatës për ndotësit e rrezikshëm (p.sh. mërkuri) ○ Lidhja midis menaxhimit të dobët të mbetjeve dhe sëmundjeve të transmetueshme ○ Ekspozimi ndaj ndotësve të ajrit, ujit dhe tokës nga mbetjet, sipas standardeve ndërkombëtare ○ Standardet ndërkombëtare për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme dhe spitalore Çështjet me rëndësi kombëtare ○ Rreziku nga përhapja e sëmundjeve për shkak të grumbullimit informal të mbetjeve ○ Ekspozimi i komuniteteve të ndjeshme pranë venddepozitimeve dhe zonave të ndotura ○ Mungesa e menaxhimit të mbetjeve spitalore dhe biologjike në përputhje me standardet ○ Ndotja e ujit, ajrit dhe tokës që ndikon në cilësinë e jetës dhe shëndetin e qytetarëve ○ Mungesa e sistemeve të paralajmërimit dhe reagimit për rreziqet mjedisore ndaj shëndetit
OSM6	Habitatet, Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura	Çështjet me rëndësi ndërkombëtare ○ Zbatimi i Konventës së Diversitetit Biologjik (CBD) ○ Konventa e Bernës për ruajtjen e specieve të egra dhe habitateve natyrore ○ Konventa e Ramsarit për zonat ligatinore me rëndësi ndërkombëtare ○ Direktiva e BE-së për Habitatet (92/43/EEC) ○ Direktiva e BE-së për Zogjtë (2009/147/EC) ○ Marrëveshja e Barcelonës dhe Protokolli për zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare në Mesdhe Çështjet me rëndësi kombëtare ○ Degradimi i habitateve nga menaxhimi i dobët i mbetjeve

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

		○ Ndotja e zonave të mbrojtura dhe ekosistemeve të ndjeshme nga venddepozitimet e paligjshme ○ Prania e mbetjeve në ligatina, lumenj, zona pyjore dhe bregdetare me vlera ekologjike ○ Mungesa e masave për mbrojtjen e biodiversitetit nga ndotja plastike dhe kimike ○ Mungesa e monitorimit dhe kontrollit të ndikimeve të mbetjeve në zonat e mbrojtura dhe në speciet e rrezikuara
OSM7	Tokat dhe burimet tokësore	Çështjet me rëndësi ndërkombëtare ○ Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG 15 – Jetë në tokë) ○ Përafrimi me standardet e BE-së për parandalimin e ndotjes dhe degradimit të tokës ○ Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme sipas Konventës së Bazelit ○ Marrëveshjet ndërkombëtare për ruajtjen e burimeve natyrore dhe tokës bujqësore Çështjet me rëndësi kombëtare ○ Degradimi i tokës nga venddepozitimet informale dhe mbetjet inerte ○ Ndotja e tokës nga ujërat e ndotura dhe mbetjet e pakontrolluara urbane e industriale ○ Zënia e tokës bujqësore nga aktivitetet joformale të depozitimit të mbetjeve ○ Mungesa e rehabilitimit të zonave të ndotura dhe të shfrytëzuara për depozitim ○ Mungesa e politikave vendore për mbrojtjen e tokës nga ndotja dhe erozioni
OSM8	Menaxhimi i Zonës Bregdetare	Çështjet me rëndësi ndërkombëtare ○ Zbatimi i Konventës së Barcelonës për mbrojtjen e detit Mesdhe nga ndotja ○ Marrëveshjet ndërkombëtare për menaxhimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare dhe ekosistemeve detare ○ Direktiva e BE-së për Menaxhimin e Zonave Bregdetare (2008/56/EC – Strategjia Detare Evropiane) ○ Parandalimi i ndotjes plastike dhe kimike në zonat bregdetare ○ Bashkëpunimi ndërkombëtar në menaxhimin e burimeve detare dhe mbrojtjen e biodiversitetit bregdetar Çështjet me rëndësi kombëtare ○ Ndikimi i mbetjeve urbane dhe turistike në ndotjen e plazheve dhe detit në Durrës ○ Mungesa e kontrollit dhe menaxhimit të venddepozitimeve pranë vijës bregdetare

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

		○ Ndotja nga ujërat e zeza dhe rrjedhjet e papërpunuara në zonat bregdetare ○ Degradimi i habitateve bregdetare për shkak të ndotjes dhe aktivitetit njerëzor të pakontrolluar ○ Mungesa e masave për menaxhimin integruar të zonës bregdetare dhe zbatimi i ligjit për zonat e mbrojtura bregdetare
OSM9	Trashegimi kulturor & Peisazhet	Çështjet me rëndësi ndërkombëtare ○ Konventa e UNESCO-së për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore, Kulturore dhe Natyrore ○ Marrëveshjet ndërkombëtare për ruajtjen e peisazheve kulturore dhe natyrore ○ Rëndësia e peisazheve për ruajtjen e biodiversitetit dhe identitetit kulturor ○ Parimet e Konventës Europiane për Peisazhet (Florenca, 2000) ○ Zbatimi i direktivave të BE-së për mbrojtjen e peisazheve dhe trashëgimisë kulturore Çështjet me rëndësi kombëtare ○ Ndikimi i menaxhimit të dobët të mbetjeve në zonat me vlera kulturore dhe peisazhe natyrore në Durrës ○ Ndotja dhe degradimi i sitëve historike dhe arkeologjike nga venddepozitimet e paligjshme ○ Mungesa e planifikimit të integruar për mbrojtjen e peisazheve urbane dhe rurale ○ Presioni urban dhe turistik mbi peisazhet natyrore dhe kulturore ○ Nevoja për ndërgjegjësim dhe përfshirje të komunitetit në ruajtjen e trashëgimisë dhe peisazheve

Përgatitja e Raportit Paraprak të VSM

Vështrim i përgjithshëm dhe rezultatet

Rezultatet e Raportit Paraprak të VSM-së (ky Raport) përcaktohen sipas Ligjit 91/2013, neni 10. Raporti Paraprak i VSM-së së pari duhet të përshkruajë qëllimin e përgjithshëm dhe objektivat kryesore të planit ose programit dhe përputhshmërinë e tij me planet ose programet e tjera që lidhen me atë, aty ku është e rëndësishme. Plani, objektivat e tij dhe masat e propozuara janë të përshkruara në Kapitullin 2.

Kapitulli 3 përshkruan fazat dhe qasjen metodologjike të procesit të VSM-së (ky Kapitull).

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Kapitulli 4 paraqet një përmbledhje të PVMIM, duke përshkruar gjendjen ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Durrës.

Kapitulli 5 kryen një “vlerësim të përputhshmërisë” strategjike të dokumentit të PVMIM, veçanërisht në lidhje me legjislacionin përkatës dhe objektivat strategjike mjedisore.

Kapitulli 6 kryen një rishikim të strategjive të jashtme sektoriale dhe çdo ndikimi të mundshëm, kërcënim ose mundësi në lidhje me zbatimin e PVMIM.

Kapitulli 7 identifikon çështjet kryesore, parametrat dhe treguesit që do të përdoren për të monitoruar përputhshmërinë e VSM-së të Planit, nën ombrellën e “monitorimit”.

Kapitulli 8 është një rishikim përmbyllës i çdo mangësie ose dobësie në përputhshmërinë legjislative ose objektive mjedisore të identifikuar si në Kapitullin 5 ashtu edhe në Kapitullin 6. Këto mangësi (të mbështetura edhe nga komentet e mëvonshme nga procesi i konsultimit) përbëjnë bazën e Veprimeve Strategjike me Përparësi të rekomanduara (VSP).

Është një kërkesë e procedurave të PVMIM dhe VSM-së që këto VSP dhe përgjigjet e konsultimit të rishqyrtohen siç duhet në Programin e Masave të PVMIM dhe/ose të pranohen ose refuzohen së bashku me arsyetimet.

Kapitulli 5 - Plani i Vlerësimit Strategjik Mjedisor Specifik

Vlerësimi i përputhshmërisë së Planit ka dy seksione kryesore:

- a) Rëndësia e Planit dhe përputhshmëria me legjislacionin e BE-së dhe atë kombëtar;
- b) Shkalla në të cilën Plani adreson mjaftueshëm kërkesat e “Objektivave Strategjike Mjedisore” (OSM) siç janë përcaktuar në Tabelën 3-2.

Qëllimi i përgjithshëm i Kapitullit 5 është të identifikojë problematikat afatgjata të grumbulluara, koordinimin ndërsektorial, problemet e mundshme me raportimin dhe pajtueshmërinë, qeverisjen dhe në përgjithësi të dërgojë mesazhe të drejtpërdrejta te sektorët e tjerë ekonomikë në lidhje me detyrimet specifike mjedisore afatgjata.

Kapitulli 6 - Vlerësimi Strategjik Mjedisor Ndërsektorial

Një objektiv kryesor i kapitullit 6 (vlerësimi ndërsektorial) është të rishikojë të gjitha strategjitë e tjera ekonomike të rëndësishme aktualisht në fuqi në Shqipëri dhe të nxjerrë në pah (duke përdorur konceptin e OSM-ve) nëpërmjet një sistemi të thjeshtë vlerësimi, aty ku strategjitë e jashtme sektoriale ekonomike mund të mbështesin objektivat e gjera të PVMIM dhe ku mund të përbëjnë “kërcënime” për zbatimin e suksesshëm të tij.

Njëlloj, kjo analizë shërben për të informuar palët e interesuara për detyrimet e tyre afatgjata dhe ndoshta detyrimet e grumbulluara mjedisore brenda PVMIM.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Aty ku ndikimi sektorial në objektivat mjedisore të PVMIM pritet të jetë i lartë dhe nëse strategjia sektoriale ose Vlerësimi i saj Strategjik Mjedisor nuk duket se e adreson në mënyrë të kënaqshme mënyrën se si do të menaxhohen këto ndikime, veprimet e mundshme dhe/ose masat bashkëpunuese që kërkohen nga ai sektor janë nënvizuar për konsultim të mëtejshëm nën Kapitullin 8 - Veprimet strategjike me përparësi të rekomanduara.

Kapitulli 7 - Monitorimi dhe Raportimi

Është një kërkesë ligjore e ligjit 91/2013 për të paraqitur procedurat për monitorimin e përputhshmërisë mjedisore të Planit në nivel strategjik. Kjo përfshin analizën teknike dhe elementet e raportimit.

Monitorimi dhe raportimi i bazuar në tregues është një aktivitet kyç kryesor i detyrimeve mjedisore të shteteve anëtare.^{9 10}

Kapitulli 8 – Veprimet strategjike me përparësi të rekomanduara

Duke marrë parasysh ndërlidhjet më të gjera, grumbulluese, afatgjata ose institucionale të Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, rezultati kryesor i Raportit Paraprak të VSM-së është të përmbledhë një sërë “veprimesh strategjike me përparësi” të cilat janë thelbësore për ofrimin efikas dhe të integruar të mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi.

Infrastruktura e gjerë mbështetëse e monitorimit, veprimet e politikave, udhëzimet teknike për operatorët, përputhshmëria dhe zbatimi ligjor dhe kërkesat e bashkëpunimit/koordinimit ndërmjet agjencive rregullatore janë të gjitha çështje themelore institucionale dhe/ose qeverisëse që gjithashtu duhet të jenë “të përshtatshme për qëllimin” në mënyrë që të ofrohet një Mjedis i Qëndrueshëm. Aty ku këto aktivitete nuk janë të përshtatshme për qëllimin, ka të ngjarë që do të kërkohen ndryshime apo përmirësime të rëndësishme në një nivel strategjik.

Veprimet strategjike me përparësi të rekomanduara janë identifikuar në një listë të shkurtër midis kapitullit 4 deri në kapitullin 7 dhe janë veçanërisht të rëndësishme për konsultimin e palëve të interesuara.

Procedurat e Konsultimit

Raporti Paraprak i VSM-së është kryesisht një raport konsultimi, duke u dhënë palëve të interesuara mjedisore, agjencive të tjera përgjegjëse qeveritare dhe publikut të gjerë një mundësi për të komentuar nëse objektivat ndërkombëtare, kombëtare ose rajonale të mbrojtjes së mjedisit janë adresuar në mënyrë të kënaqshme në Plan dhe gjithashtu për të komentuar mbi ndërlidhjen e PVMIM me strategjitë e tyre sektoriale.

⁹ <https://www.eea.europa.eu/data-and-maps>

¹⁰ <https://www.eea.europa.eu/ims>

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Procedurat e konsultimit (mekanizmat, palët e interesuara të konsultuara, datat) të Raportit Paraprak të VSM-së janë paraqitur më poshtë.

Legjislacioni përkatës i BE-së dhe ai Kombëtar

Hartimi dhe zbatimi i planeve lokale të menaxhimit të mbetjeve në nivel bashkie mbështetet në përputhje të plotë me **Direktivën Kuadër të BE-së Për Mbetjet** (2008/98/EC, e ndryshuar me 2018/851), e cila përcakton hierarkinë e mbetjeve si parim udhëzues: parandalimi, ripërdorimi, riciklimi, rikuperimi dhe, si zgjidhje e fundit, depozitimi në landfill. Kjo direktivë, së bashku me objektivat e riciklimit të mbetjeve bashkiake (55% deri më 2025, 60% deri më 2030, 65% deri më 2035), është themeli mbi të cilin duhet të orientohet edhe planifikimi lokal.

Përveç saj, një sërë direktivash të tjera të BE-së japin kornizën sektoriale: Direktiva për Landfille (1999/31/EC) përcakton kërkesat teknike dhe kufizimet për depozitimin e mbetjeve; Direktiva për Paketimin dhe Mbetjet e Paketimit (94/62/EC, ndryshuar me 2018/852) vendos objektiva për rikuperimin dhe riciklimin e paketimit nëpërmjet skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (EPR); ndërsa Direktiva për Plastikën me Përdorim të Vetëm (2019/904) detyron bashkitë të parashikojnë masa për reduktimin dhe ndalimin e disa produkteve plastike. Njëkohësisht, direktivat për rrjedhat e veçanta si WEEE (2012/19/EU) për pajisjet elektrike/elektronike, RoHS (2011/65/EU) për substancat e rrezikshme, si dhe Rregullorja e re e Baterive (2023/1542), vendosin objektiva të detyrueshme për grumbullimin, riciklimin dhe gjurmueshmërinë e këtyre mbetjeve. Këto kërkesa, të kombinuara me rregulloret mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm (POPs) dhe transportet ndërkufitare të mbetjeve, sigurojnë që menaxhimi i mbetjeve të jetë i qëndrueshëm, transparent dhe në linjë me standardet e larta të mbrojtjes së mjedisit.

Në nivel kombëtar, Shqipëria e ka përafruar këtë kuadër me Ligjin nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i cili përcakton parimet bazë të menaxhimit të mbetjeve, detyrimet për ndarjen në burim dhe përgjegjësitë institucionale. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton rolin e bashkive si autoritet përgjegjës për organizimin e shërbimit të pastrimit, vendosjen e tarifave dhe hartimin e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve. Po ashtu, Ligji nr. 91/2013 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor kërkon që këto plane të jenë subjekt i vlerësimit të ndikimeve mjedisore, duke garantuar që objektivat e tyre të jenë në harmoni me zhvillimin e qëndrueshëm.

Në nivel planifikimi kombëtar, Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020–2035 (VKM nr. 418, datë 27.5.2020) vendos drejtimet kryesore, objektivat e reduktimit të mbetjeve që depozitohen në landfill dhe rritjes së riciklimit. Ky plan shërben si udhërrëfyes për bashkitë në hartimin e planeve lokale, të cilat duhet të jenë të përputhshme me objektivat dhe treguesit kombëtarë.

Në vijimësi, një sërë vendimesh të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimesh sektoriale rregullojnë menaxhimin e flukseve të veçanta: VKM nr. 177/2012 për paketimin, VKM nr. 957/2012 për pajisjet elektrike dhe elektronike, VKM nr. 866/2012 për bateritë dhe

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

akumulatorët, si dhe udhëzimet për projektimin dhe funksionimin e landfilleve. Një element i rëndësishëm është edhe katalogu shqiptar i klasifikimit të mbetjeve, i cili përafron sistemin e BE-së për kodimin e mbetjeve dhe siguron uniformitet në raportim dhe planifikim.

Në këtë mënyrë, kuadri i BE-së përcakton standardet dhe objektivat afatgjata, ndërsa kuadri kombëtar shqiptar i përthith ato duke i konkretizuar në legjislacion, strategji dhe akte nënligjore. Planet vendore duhet të veprojnë si ura lidhëse: nga njëra anë, duke reflektuar objektivat evropiane dhe kombëtare, dhe nga ana tjetër, duke i përshtatur ato me realitetin lokal, kapacitetet komunale dhe nevojat e komunitetit.

Në nivel kombëtar, ekziston detyrimi për të kryer një vlerësim strategjik mjedisor dhe për të përgatitur një raport të VSM-së për PVMIM e Bashkisë Durrës. Procedura e informimit dhe konsultimit të publikut zhvillohet në përputhje me Ligjin Nr. 91/2013 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 219, datë 11.3.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimit me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”.

Ligjet përkatëse janë Ligji nr. 119/2014 për të drejtën e informimit dhe “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Procesi i konsultimit

Përfshirja e publikut dhe e palëve të interesit zbatohet në faza të ndryshme të vlerësimit strategjik mjedisor. Në këtë aspekt, në përputhje me nenin 8, kreu II i Ligjit për VSM-në përcakton njoftimin dhe konsultimin me palët e interesit për çështjet e VSM-së, që paraqet hapin e parë në përfshirjen e palëve të ndryshme të interesuara në hartimin e Raportit të VSM-së.

Për më tepër, neni 9 i Ligjit për VSM-në thekson konsultimin për çështjet që duhet të adresohen në raportin e VSM-së dhe, nëse palët e interesuara kanë kërkesa ose sugjerime për çështje që duhet të adresohen në raportin e VSM-së, ato merren parasysh nga autoriteti kompetent (Bashkia Durrës) gjatë hartimit të Raportit Paraprak. Hartimi dhe konsultimi i Raportit Paraprak të VSM-së me publikun dhe palët e interesit parashihet në nenin 10 të Ligjit të VSM-së. Pas publikimit të Raportit Paraprak të VSM-së, Bashkia Durrës kryen konsultimin me publikun dhe palët e interesuara, përfshirë edhe OJQ-të.

Komentet e marra nga të gjitha palët e interesuara dhe publiku i gjerë shqyrtohen nga autoriteti kompetent dhe aty ku është e përshtatshme, mund të bëhen ndryshime ose përf forcime për objektivat mjedisore dhe/ose masat e përshkruara në PVMIM.

Të dhënat e konsultimit dhe veprimet që propozohen do të jenë dokumentuar në Raportin Përfundimtar të VSM-së.

Raporti Paraprak VSM-së u publikua për konsultim në datën **1 Tetor 2025**, periudha e konsultimit zgjat 30 ditë.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Përgatitja e Raportit Përfundimtar të VSM-së

Kërkesat e Raportit Përfundimtar të VSM-së përcaktohen sipas Ligjit 91/2013, neni 11. Në thelb, Raporti Përfundimtar i VSM-së duhet të përmbledhë përgjigjet e konsultimit ndaj Raportit Paraprak të VSM-së dhe nëse kërkohen apo jo ndryshime/shtesa në Programin e Masave.

Shkalla në të cilën këto përgjigje kanë shkaktuar ndryshime në draftin e Programit të Masave të Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve duhet të dokumentohen. Po kështu, nëse disa përgjigje ose rekomandime nga konsultimi janë refuzuar nga Autoriteti Propozues (Bashkia Durrës), këto duhet të arsyetohen në Raportin Përfundimtar të VSM-së.

Është e mundur që disa/të gjitha Veprimet Strategjike Me Përparësi (VSP) të Raportit Paraprak të VSM-së që janë identifikuar nëpërmjet:

- Vlerësimi specifik strategjik i Planit të Raportit Paraprak – Kapitulli 5;
- Vlerësimi specifik strategjik sektorial i Raportit Paraprak – Kapitulli 6;
- Konsultimeve me palët e interesuara që i përgjigjen Raportit Paraprak – Konsultimet;

të mos jenë pasqyruar plotësisht në draftin e Programit të Masave.

Në këtë rast, VSP-të e identifikuar si pjesë e procesit të VSM-së duhet të përfshihen si shtesë në Programin e Masave të PVMIM. Kjo siguron që çështjet e gjera strategjike të natyrës legislative, institucionale, koordinuese ose grumbulluese të mos anashkalohen nga Plani.

Tabela 3-3– Rezultatet e Konsultimit Gjithëpërfshirës

Ministria / Agjencia / Institucioni	Temat më të rëndësishme mjedisore	Çështjet e përmendura si të rëndësishme
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Biodiversiteti	mbrojtja e natyrës dhe qasja që ky plan do të ketë ndaj zonave që do të identifikohen si të rëndësishme për habitatet, florën dhe faunën
	Zonat e mbrojtura	qasja që do të ketë ky plan ndaj zonave të mbrojtura dhe atyre që mund të miratohen në të ardhmen
	Uji	plani duhet të identifikojë pikat më të nxehta të venddepozitimeve që mund të ndikojnë në ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore dhe të propozojë masa për të minimizuar këtë ndotje.
	Mbetjet	plani duhet të analizojë situatën aktuale të mbetjeve dhe të identifikojë problemet pas kryerjes së analizës, si dhe të vendosë disa masa që duhen zbatuar.
	Ndryshimi i klimës	plani duhet të marrë në konsideratë ndikimet që lidhen me ndryshimet klimatike

4. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I BASHKISË

4.1 Të dhëna gjeografike

Bashkia Durrës ndodhet në pjesën qendrore perëndimore të Shqipërisë, përgjatë bregdetit të Detit Adriatik me një territor prej 329 km², e cila kufizohet në veri me Bashkinë Kurbin, në veri veri lindje me Bashkinë Krujë, në lindje me Bashkitë Tiranë dhe Shijak, në jug me Bashkinë Kavajë dhe në perëndim nga Deti Adriatik.

Me një sipërfaqe të zgjeruar pas reformës territoriale të vitit 2015, Bashkia Durrës përfshin një territor të gjerë që shtrihet nga zona urbane bregdetare deri në rajonet rurale e kodrinore në lindje dhe veri të saj duke u përbërë nga 6 njësi administrative të cilat janë: Durrës, Sukth, Rrashbull, Ishëm, Katund i Ri dhe Xhafzotaj. Ky pozicion e bën Durrësin një nga nyjet më të rëndësishme të Shqipërisë për transportin, turizmin dhe zhvillimin ekonomik.

Durrësi, bashkia e dytë më e madh në Shqipëri për nga popullsia, shërben si porta kryesore detare e vendit falë Portit të Durrësit – më i madhi në vend dhe një nga nyjet më të rëndësishme tregtare në rajon. Ky port lidh Shqipërinë me rrjetet e transportit detar në Mesdhe dhe Evropë, duke luajtur një rol kyç në përpunimin e importeve dhe eksporteve të vendit.

Pozicioni i Durrësit përgjatë Korridorit VIII, një rrugë ndërkombëtare që lidh Adriatikut me Detin e Zi (nga Durrësi deri në Bullgari përmes Maqedonisë së Veriut), e bën atë një qendër të rëndësishme për transportin dhe logjistikën në Ballkan. Për më tepër, autostrada Durrës-Kukës-Prishtinë e lidh qytetin me Kosovën, duke ndihmuar në rritjen e shkëmbimeve ekonomike mes dy vendeve.

Territori i Bashkisë Durrës përfshin një kombinim të zonave urbane, kodrinore, fushore dhe bregdetare, me një lartësi maksimale prej 269 m mbi nivelin e detit në kodrat e Ishmit dhe një lartësimesatare prej 89 m mbi nivelin e detit.

- **Zona bregdetare:** Shtrihet përgjatë Adriatikut, me plazhe të gjera me rërë, që përbëjnë një nga destinacionet kryesore turistike të vendit. Plazhi i Durrësit, Gjiri i Lalëzit dhe Kallmi janë disa nga pikat më të njohura.
- **Zona fushore:** Pjesa qendrore e bashkisë përbëhet nga fusha pjellore, të cilat janë të rëndësishme për bujqësinë dhe industrinë agro-përpunuese.
- **Zona kodrinore:** Në lindje dhe veri të bashkisë ndodhen kodrat e Ishmit, Manzës dhe Sukthit, të cilat përbëjnë zona të rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm, bujqësi dhe turizëm natyror.

Durrësi ka një klimë tipike mesdhetare, me dimër të butë dhe me reshje të moderuara me temperaturë mesatare të janarit në 7°C, si dhe verë të nxehtë e të thatë me temperaturë mesatare të gushtit 24°C, dhe me një temperaturë mesatare vjetore prej 16°C çka ndikon

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

pozitivisht në zhvillimin e turizmit dhe agrikulturës së bashkisë të cilët tanimë janë kthyer në gjithëvjetor. Sa i përket sistemeve të territorit në bashkisë Durrës ato janë të ndara në 5 kategori kryesore¹¹: a) bujqësor 16,501 ha ose 47.9 %, infrastrukturor 698 ha ose 2%, natyror 10,815 ose 31.4 %, urban 5,137 ose 14.9 %. Vërehet qartë edhe nga ndarja e sistemeve se sistemi bujqësor dhe ai natyror zënë pjesën më të madhe të sipërfaqes së bashkisë e nga ana tjetër verëhet se sipërfaqja e tretë e zë sistemi urban i cili me gjasë pritet të rritet bazuar edhe në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Durrës.

Bashkia Durrës ka një prani të konsiderueshme të burimeve ujore, duke përfshirë Lumin Erzen i cili kalon mes përmes territorit të bashkisë dhe Lumit Ishëm i cili kalon në pjesën veriore të bashkisë. Në territorin e bashkisë ka dhe një rrejt të dendur të kalaveve kulluese dhe vaditëse të cilat janë pozicionuara kryesisht në zonën qendrore të bashkisë e cila është kryesisht zonë fushore si dhe disa rezervuare të cilët shërbejnë për vaditje gjatë stinës së verës ku ndërmë të rëndësishmit mund të përmendim atë të Gjepalit dhe Sukthit.

Pozicioni gjeografik i Bashkisë Durrës e bën atë një qendër kyçe për transportin, tregtinë dhe turizmin në Shqipëri. Si një nyje ndërkombëtare e shkëmbimeve detare dhe tokësore, Durrësi ka një avantazh të jashtëzakonshëm për zhvillimin ekonomik dhe integrimin në tregjet ndërkombëtare. Gjithashtu, pasuritë natyrore dhe klima e favorshme e bëjnë atë një destinacion të rëndësishëm turistik dhe bujqësor. Për të ardhmen, planifikimi urban dhe mbrojtja e ekosistemeve do të jenë thelbësore për një zhvillim të qëndrueshëm të qytetit dhe rajonit përreth.




Figura 4-I: Harta e pozicionimit të Bashkisë Durrës

¹¹ Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Durrës, Plani i Zhvillimit të Territorit, miratuar në datë 27.07.2022.

4.2 Të dhëna administrative

Bashkia Durrës përbëhet nga gjashtë njësi administrative: Durrës, Sukth, Ishëm, Katundi i Ri, Rrashbull dhe Manëz.

Njësia Administrative Durrës me një sipërfaqe prej 40 km² është qendra kryesore administrative dhe urbane e bashkisë në të cilin janë vendosur edhe godinat kryesore administrative, bizneset kryesore si dhe porti i Durrsit. Nj.A. Durrës ka numrin më të lartë të banorëve në të gjithë territorin e bashkisë dhe është një pikë kyçe e zhvillimit ekonomik të bashkisë. Për çështje administrative të bashkisë Nj.A. Durrës është e ndarë në 6 Rajone të përbëra nga lagje të cilat paraqiten në tabelën më poshtë.

Njësia Administrative Sukth, me një sipërfaqe prej 50 km² është e përbërë nga qyteti i Sukthit dhe fshatrat Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori. Kjo njësi ka një pozicion të favorshëm pranë autostradës Durrës-Tiranë, duke e bërë atë të përshtatshme për zhvillimin e industrisë dhe shërbimeve të logjistikës. Gjithashtu, për shkak të territorit të sajë kjo njësi ka potencial për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

Njësia Administrative Ishëm me një sipërfaqe prej 84 km² është njësia më e madhe për nga territori në bashki dhe është e përbërë nga fshatrat Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjericaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj. E njohur për vijën e sajë bregdetare dhe natyrën e pasur, kjo njësi ka potencial të lartë për zhvillimin e turizmit natyror dhe ekoturizmit. Gjiri i Lalëzit është një destinacion më i njohur për qytetarët dhe turistët për shkak të plazheve të shumta dhe investimeve që janë bërë kohët e fundit në sektorin e turizmit duke i dhënë një zhvillim të rëndësishëm të gjithë zonës.

Njësia Administrative Katundi i Ri me një sipërfaqe prej 51 km² dhe është e përbërë nga fshatrat Katundi i Ri, Jubë, Qerret, Fllakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik. Kjo njësi ka një relief fushor dhe karakterizohet nga një tokë pjellore e cila duke shfrytëzuar ujin e Lumit Erzen i cili kalon në pjesën veriore të njësive mund të shfrytëzohet për zhvillimin e bujqësisë intensive.

Njësia Administrative Rrashbull me një sipërfaqe prej 55 km² dhe është e përbërë nga fshatrat Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanxhije, Xhafzotaj. Kjo njësi ka një kombinim të zonave rurale dhe urbane, me potencial për zhvillimin e agroturizmit dhe industrisë së lehtë. Afërsia me qytetin e Durrsit e bën atë të përshtatshme për zhvillimin e banesave dhe shërbimeve.

Njësia Administrative Manëz me një sipërfaqe prej 49 km² dhe është e përbërë nga fshatrat Manëz, Rade, Shkallë, Karpen, Shetel, Kullas, Pjezë, Dushk. E vendosur në një zonë kodrinore, kjo njësi ka potencial për zhvillimin e turizmit të peizazhit dhe eksperiencës, nëpërmjet aktiviteteve në natyrë. Gjithashtu, duke u bazuar tek karakteristikat e relievit zona është e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, duke ofruar produkte organike për tregun e Tiranës dhe Durrsit të cilët janë ndër tregjet më të mëdha në vend.




Figura 4-II: Harta e ndarjes administrative e Bashkise Durrës.

Sipërfaqja totale e bashkisë Durrës është 329 km² ku njësia administrative me sipërfaqen më të madhe është ajo e Ishmit me 84 km² e ndjekur nga njësia Rrashbull me 55 km². Ndërsa njësia administrative me sipërfaqe më të vogël është Durrësi me 40 km².

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës


Tabela 4-1: Të dhëna administrative Bashkia Durrës

Bashkia	Njësitë Administrative	Sipërfaqe në km2	Qytete dhe Fshatra
Durrës	Durrës	40	Qyteti Durrës: Rajoni 1, lagjet 1, 2,3, 4; Rajoni 2, lagjet 6, 7, 9, 10, 11; Rajoni 3, lagje 5, 12, 16; Rajoni 4, lagjet 8, 15, 18; Rajoni 5, lagjet 17, 13, 14; Rajoni 6, lagjet 5, 4, 3.
	Sukth	50	Qyteti Sukth; Fshatrat: Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori.
	Ishëm	84	Fshatrat: Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjuricaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj.
	Katundi i ri	51	Fshatrat: Katundi i Ri, Jubë, Qerret, Fllakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik.
	Rrashbull	55	Fshatrat: Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanxhiye, Xhafzotaj.
	Manëz	49	Qyteti Manëz; Fshatrat: Armath, Borç, Hamallaj, Kameras, Radë, Shkallë, Fshat Manëz.
	Total	329	3 qytete dhe 39 fshatra

4.3 Gjendja e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve

- Mbledhja dhe transporti i mbetjeve

Shërbimi i mbledhjes dhe transportit të mbetjeve në Bashkinë Durrës aktualisht ofrohet në të 6 njësi administrative. Sa i përket përqindjes së mbulimit me shërbim të popullsisë zyrtarët e bashkisë deklarojnë se mbulojnë 100% të popullsisë banuese në territorin e bashkisë.



Grafiku 1: Popullsia e mbuluar me shërbim

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Referuar të dhënave të mbledhura nga Bashkia e Durrës, sasia totale e mbetjeve të grumbulluara në vitin 2023 është 67,094 ton. Bazuar në sasin e mbetjeve të grumbulluara dhe numrit të banorëve të shërbyer, përllogaritet një normë gjenerimi prej 0.54 kg mbetje për banorë në ditë.

Tabela 4-2: Të dhëna mbi ofrimin e shërbimit

Tipi i të dhënave	Vlera
Numri i popullsisë që merr shërbim	343,558
% popullsisë që merr shërbim	100%
Sasia e mbetjeve të gjeneruara (e vlerësuar në ton/vot)	67,094
Sasia e mbetjeve të mbledhura (ton/vit)	67,094
Mbetje të gjeneruara (kg/banorë/ditë)	0.54 kg/banorë/ditë
Frekuenca e mbledhjes së mbetjeve në secilën nga zonat e shërbimit	
a. Zona 1 (Urbane)	10 herë/javë
b. Zona 2 (Rurale)	7 herë/javë

Shërbimi ofrohet 10 herë në javë në zonën urbane, kryesisht njësinë administrative Durrës, pasi në disa zona të njësisë shërbimi ofrohet edhe dy herë në ditë për shkak të volumit të lart të mbetjeve. Ndërsa në njësitë e tjera administrative shërbimi ofrohet 7 herë në javë duke siguruar një shërbim të vazhdueshëm për banorët e bashkisë. Duhet theksuar se gjatë sezonit të verës, për shkak të rritjes së konsumit nga prania e lartë e turistëve, Bashkia Durrës shton numrin e konteinerëve në territor si dhe rrit frekuencën e shërbimit, veçanërisht në zonat turistike dhe në qytet

4.3.1 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve

Riciklimi i mbetjeve

Në bashkinë Durrës nuk kryhet grumbullimi dhe mbledhja e ndarë e mbetjeve sipas rrymave të riciklueshme. Sektori joformal i riciklimit, është i pranishëm në bashki, gjithsesi i kufizuar në një numër të vogël njerëzish të cilët mbledhin nga konteinerët rrymat e riciklueshme të mbetjeve, kryesisht plastikë dhe metal dhe më pas i trgtojnë ato tek bizneset e riciklimit.

Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve

Bashkia e Durrësit për shkak të problematikës me depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane në venddepozitimin e ndodhur në zonën e Porto Romanos me vendim të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 533, datë 10.07.2018 vendosi ti këkrojë Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve:

- Shpalljen e emergjencës mjedisore në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Durrës.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

- Gjetja e një alternative për depozitimin e mbetjeve;
- Kërkimi i mbështetjes teknike si dhe ti jepet e drejta kryetarit të bashkëpunojë me Institucionet e qeverisjes Vendore dhe Koncesionarin e landifillit të Tiranës për gjetjen e një zgjidhje efikase për depozitimin e mbetjeve dhe zgjidhjen e situatës së emergjencës.

Në vijim të shpalljes së emergjencës mjedisore Këshilli Bashkiak Durrës me Vendimin nr.68 datë 10.06.2021 vendosi:

- a) Miratimin e skenarit të menaxhimit të mbetjeve, bazuar në Vendimin nr. 6, datë 20.05.2021 të Komitetit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Vendimit nr. 3, datë 02.06.2021 të këshillit të Qarkut Durrës, sipas relacionit bashkëngjitur.
- b) Të kërkohet nga Qeveria Shqiptare ose organe përfaqësuese të saj për të marrë përsipër realizimin e investimeve të nevojshme lidhur me stacionin e transferimit ku do të depozitohet bashkia Durrës duke marrë parasysh kufijtë administrativ të Bashkive të Qarkut Durrës në pika të arritshme edhe nga bashki të tjera.
- c) Të kërkohet nga Qeveria Shqiptare miratimin e subvencionit të plotë të tarifës hyrëse për një afat 10 vjeçar sipas planit afatgjat të buxhetit, suke qenë se Bashkia Durrës ka kaluar pasoja qoftë prej pandemisë, globale ashtu edhe prej gjendjes së jashtëzakonshme shpallur si rrjedhim të goditjes nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 me VKM-në nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”.
- d) Të kërkohet nga Bashkia Durrës të bashkëpunojë me Bashkinë e Tiranës për të vijuar më tej procedurat në zbatim të dispozitave ligjore administrative në fuqi, kjo në bazë të pikës 9.2.2 Zona e Menaxhimit të Mbetjeve në vendim nr. 01, datë 13.01.202 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta” Strategjinë Sektoriale, “Planin e Zhvillimit të Sektorit dhe Harta Bazë” nga ku nevojitet që çdo bashki të jetë pjesë e një ZMN-je, në rastin e bashkisë Durrës, ZMM Tiranë - Durrës përfshin Qarkun Tiranë dhe Qarkun Durrës duke qenë se landfilli i Sharës dhe impianti i trajtimit të mbetjeve, që do të ndërtohet ndodhet nën territorin e administrimit të Bashkisë Tiranë.

Bazuar në këto vendime, në vitin 2021 Bashkia Durrës ka lidhur një kontratë me Integrated Energy BV SPV operatori privat i cili operon landfillin e Sharrës për depozitimin e mbetjeve të grumbulluara në territorin e bashkisë Durrës në këtë landfill.

4.3.2 Përmbledhje e gjetjeve kryesore të gjendjes fillestare

➤ Burimet njerëzore dhe mjetet

Në bashkinë Durrës shërbimi për menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkiake ofrohet nëpërmjet dy ndërmarjeve të shërbimit NSHKD ofron shërbim në Nj.A. Durrës Katund i Ri dhe

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Manëz, NKP ofron shërbim në njësinë administrative Rrashbull dhe në një pjesë të Durrsit më saktësisht të Rajonit 5. Ndërsa, për të ofruar shërbim në njësitë administrative Sukth dhe Ishëm, NSHKD ka kontraktuar subjektin AFA Group Shpk i cili është një subjekt privat dhe është përgjegjës për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në këto njësi administrative. Në Bashkinë Durrës në të dy ndërmarrjet janë të punësuar 428 persona të cilët janë të ndarë në a) administratë në nivel zyre, të tillë si drejtor, financier, jurist etj.; b) administratë të cilët punojnë në terren të tillë si përgjegjës sektori, brigadier; c) punonjës të pastrimit në terren të cilët përfshijnë shoferët e mjeteve për grumbullimin e mbetjeve, punëtorët të cilët shoqerojnë mjetet e grumbullimit, punonjës të tjerë si fshesarë, mekanik, roje, gërryes, e krehës. Kur marrim në konsideratë numrin e banorëve të shërbyer për punonjës shërbimi kemi shifra relativisht të përafërta në njësitë administrative ku numrin në Nj.A. Ishëm një puntor ofron shërbim për rreth 1,600 persona ndërsa në Nj.A Katund i Ri një puntor ofron shërbim për 4,295 banorë. Sa i përket popullsisë së përfton shërbim për administrator në Nj.A. Rrashbull një administrator ofron shërbim për 37,837 banorë ku është numri më i lartë i popullsisë së mbuluar për administratir në nivel bashkie ndërsa niveli më i ulët është një Nj.A. Manëz ku një administrator ofron shërbim për 6,382 banorë.

Bashkia Durrës ka në pronësi 1,859 konteiner nga të cilët 751 janë plastik dhe 1,108 janë metalik ku pjesa më e madhe e tyre janë me vëllim 1.1 m³ dhe 52 prej tyre janë me vëllim 2.4 m³.

Sa i përket mjeteve në dispozicion NSHKD ka në pronësi 21 mjete ndërsa NKP ka në pronësi 22 mjete për një total prej 43 mjete. Këto mjete kanë kapacitete dhe tipologji të ndryshme dhe pjesa më e madhe e tyre ka më shumë se 10 vite punë dhe një moshë mesatare prej 21 vitesh.

➤ Gjendja e shërbimit

Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në Bashkinë Durrës ofrohet në të gjithë territorin e bashkisë me një sasi totale të grumbulluar në vitn 2023 prej 67,094 tonësh për një popullsi prej 343,558 banorësh dhe me një gjenerim të përafërt prej 0.54 kg/banorë/ditë.

Shërbimi ofrohet me një frekuencë prej 10 herësh në javë në Nj.A Durrës pasi në disa raste punonjësit e bashkisë janë të detyruar të dalin edhe 2 herë në ditë për të grumbulluar mbetjet në disa zona për shkak të gjenerimit të lartë. Ndërsa në Nj.A. e tjera shërbimi ofrohet rregullisht 7 herë në javë me një frekuencë prej një herë në ditë.

Në tërësi pikat e grumbullimit dizinfektohen në mënyrë të rregullt me klor ndërsa konteinerët dhe PGM-t lahen sipas një kalendari të brendshëm tëndërmarrjeve një shpeshtësi prej 2 herësh në javë gjat dimrit dhe më shpesh gjatë verës.

Mbetjet e grumbulluar në territorin e Bashkisë depozitohen në lëndfillin e Sharrës në Tiranë.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

➤ Gjendja Financiare

Bashkia Durrës për vitin 2023 ka realizuar shpenzime për vlerën e 931,627,324 lek për të ofruar shërbim në territorin e bashkisë për grumbullim e një sasi mbetjesh prej 67,094 ton mbetje e cila gjeneron një kosto për njësi prej 13,148 lek/ton/vit dhe 2,568 lek/banorë/vit.

Të ardhurat nga tarifa e menaxhimit të mbetjeve në bashki kanë pësuar rritje në vitin 2024 ku përqindja e realizimit të tarifave gjisej është në masën 98% ku ka një realizim prej 88% për familjarët dhe 106% për bizneset. Përtej numrave pozitiv në dukje duhet të evidentojmë se këto përqindje realizimi janë në raport me planifikimin e kryer nga bashkia dhe jo mbi potencialin faktik që ka bashkia për të tarifuar dhe vjelur të ardhura prej tyre.

➤ Problematika të shërbimit

Nga puna në terren por edhe nga diskutimet e zhvilluar me përfaqësues të bashkisë të cilët janë pjesë aktive e grupit të punës janë vërejtur problematikat e mëposhtme:

- Shpërndarja jo e rregullt e pikave të grumbullimit të mbetjeve;
- Numër i lartë i konteinerëve në disa pika grumbullimi mbetjesh;
- Pika grumbullimi të pa standardizuara;
- Pika grumbullimi ilegale/problematike (të krijuara nga komuniteti);
- Mungesa ndërgjegjësimit të komunitetit dhe bizneseve;
- Bashkëpunimi me bizneset;
- Konteiner të demtuar dhe amortizuar;
- Mjete transporti të amortizuara;
- Orari i grumbullimit të mbetjeve, në disa raste në pikun e trafikut.
- Mungesa e numrit të bizneseve të mëdhenj, të vegjël dhe të ndarë sipas kategorive të paketës fiskale.
- Mungesa e numrit të institucioneve.
- Mungesa e të dhënave për nivelin e faturimit të bizneseve dhe institucioneve
- Faturim i ulët i familjeve;
- Planifikimi i të ardhurave më i ulët se potenciali;
- Realizimi i të ardhurave më i ulët se planifikimi.

Nevojat dhe prioritetet e bashkisë për menaxhimin e MNB

Analiza e gjendjes aktuale dhe prioritetet kryesore afatshkurtra dhe afatmesme të evidentuara nga zyrtarët e bashkisë në lidhje me menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta bashkiake përmbledhen në pikat si mëposhtme:

- Miratimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për periudhën 2026 - 2030;

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

- Shtrirja e shërbimit dhe përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit edhe në zonat rurale të bashkisë;
- Riorganizimi i itinerareve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve dhe i shpërndarjes së pikave të grumbullimit të mbetjeve për të përmirësuar mbulimin dhe cilësinë e shërbimit;
- Zëvendësimi i kontejnerëve të dëmtuar dhe i flotës ekzistuese të mjeteve të transportit të mbetjeve (kamionëve të amortizuar), me pajisje dhe mjete të reja, në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe standardeve të ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve
- Ndarja e mbeturinave inerte nga ato shtëpiake dhe sistemimi i tyre në një vend të miratuar.
- Promovimi i praktikave për pakësimin e mbetjeve nëpërmjet kompostimit dhe riciklimit
- Promovimi i kompostimit në shtëpi në zonat rurale;
- Ndërtimi i një Stacioni Transferimi për MNB;
- Ndërtimi i një objekt për rikuperimin e materialeve ORM;
- Ndërtimi/ngritja e Parqeve Ekologjike për të mundësuar qytetarëve depozitimin e mbetjeve voluminoze (pajisje mobililimi të shtëpisë, pajisje elektrike dhe elektronike).
- Rregullimi i procesit të depozitimit të mbetjeve të gjelbërta nga ana e qytetarëve.
- Identifikimi, evakuimi dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ilegale me fokus kryesor ato që gjenden pranë vijave ujore;
- Ndërgjegjësimi i banorëve që të hedhin mbetjet në PGM, të ndajnë mbetjet inerte nga ato shtëpiake dhe të paguajnë tarifën e shërbimit;
- Rregullore Bashkiake për menaxhimin e mbetjeve, fshirjen, larjen etj;
- Përmirësimi i bazës së të dhënave të klientit dhe vendosja e një sistemi efektiv faturimi dhe arkëtimi;
- Ndarja e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga pastrimi dhe shërbimet e tjera publike si gjelbrim, dekor etj.
- Hartimi i një Plani për Marrëdhëniet me Publikun dhe përmirësimi i komunikimit me qytetarët dhe bizneset;
Pasi janë përcaktuar sektorët kryesorë, hapi i dytë i procedurës është analiza e ndërveprimit të tyre me objektivat mjedisore dhe sociale të planit. Këtu vlerësohet se si politikat e zhvillimit urban, turizmit, transportit, shëndetësisë apo bujqësisë ndikojnë në sasinë, përbërjen dhe mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane. Kjo analizë bëhet jo vetëm mbi bazën e situatës aktuale, por edhe në funksion të prirjeve të ardhshme, duke marrë parasysh skenarë të ndryshëm zhvillimi.

Një pjesë e rëndësishme e procedurës është vlerësimi i rreziqeve sektoriale. Në këtë fazë identifikohen mospërputhjet mes objektivave të PVMIM dhe strategjive sektoriale të jashtme, duke u fokusuar tek ato fusha ku ekziston rreziku i përkeqësimit të gjendjes mjedisore ose mbingarkesës së infrastrukturës së mbetjeve. Ky vlerësim ndihmon për të kuptuar nëse planet e tjera të zhvillimit (p.sh. zgjerimi turistik ose urbanizimi i shpejtë) mund të sjellin një sasi mbetjesh që tejkalon kapacitetet aktuale, duke rrezikuar efektshmërinë e planit.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Kjo lidhje e ndërmjetme është e rëndësishme për të siguruar që a) VSM-ja merr një qasje të përshtatshme strategjike b) por që vlerësimi ndërsektorial i VSM-së është mjaftueshëm i ndarë në "komponentët mjedisorë" në mënyrë që të jetë ende kuptimplotë në një nivel teknik c) dhe VSM kufizohet në fushëveprimin e PVMIM, përkatësisht "mbrojtja dhe përmirësimi i trupave ujorë sipërfaqësorë, ujërave nëntokësore dhe tokës".

Kriteret e përdorura për të përcaktuar nëse një sektor i jashtëm mund të ndërveprojë drejtpërdrejt ose jo me objektivat e PVMIM-së janë si më poshtë:

- **Përputhshmëria me fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane**
 - Sektorët që kanë aktivitet direkt mbi prodhimin, trajtimin, riciklimin ose shpërndarjen e mbetjeve urbane konsiderohen me ndërveprim të drejtpërdrejtë.
 - Sektorët me ndikim indirekt, të cilët mund të ndikojnë në sasinë ose cilësinë e mbetjeve (p.sh. ndërtimi, industritë e mëdha), konsiderohen me ndërveprim të tërthortë.
- **Përfshirja në politikëbërje**
 - Sektorët që hartojnë ose zbatojnë rregullativa që lidhen drejtpërdrejt me mbetjet urbane (p.sh. transporti i mbetjeve, menaxhimi i landfill-eve) kanë ndërveprim të drejtpërdrejtë.
 - Sektorët që nuk janë të lidhur drejtpërdrejt me ligjet ose udhëzimet mbi mbetjet kanë ndërveprim të tërthortë.
- **Efekti mbi burimet ose shërbimet publike**
 - Sektorët që ndikojnë drejtpërdrejt në shërbimet komunale për mbledhjen dhe përpunimin e mbetjeve (p.sh. ujësjellës, energji, transport publik) kanë ndërveprim të drejtpërdrejtë.
 - Sektorët që kanë ndikim vetëm në mënyrë të përgjithshme mbi mjedisin ose infrastrukturën mund të klasifikohen si ndërveprim i tërthortë.
- **Ndikimi në qëllimet e planit vendor**
 - Nëse aktiviteti i sektorit kontribuon ose pengon arritjen e objektivave specifike të PVMIM-së, ky konsiderohet ndërveprim i drejtpërdrejtë.
 - Nëse ndikimi është i vogël, i rrallë ose i parashikueshëm vetëm në aspekt të përgjithshëm, konsiderohet ndërveprim i tërthortë.

Vlerësimi thuajse-sasior i rrezikut të shkallës së ndikimit të mundshëm në objektivat mjedisore të PVMIM-së përdor një rezultat të thjeshtë grumbullues bazuar në këto kriteret:

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

- Nëse parashikohet ndonjë shkallë ndikimi, kjo theksohet me shënjes nën komponentin e duhur mjedisor. Komponentët individualë përmbledhen për të siguruar një rezultat të thjeshtë total.
- Nëse strategjia sektoriale përmend në mënyrë të qartë ndonjë nga komponentët mjedisorë të tabelës 6-1, qoftë në strategjinë sektoriale drejtpërdrejt, ose aty ku ajo ekziston, në VSM-në shoqëruese dhe tregon (në një farë forme) që komponenti është identifikuar si një çështje e rëndësishme dhe do të trajtohet si pjesë e strategjisë, atëherë pika theksohet **jeshile▲** dhe konsiderohet si rezultat pozitiv (+).
- Në këtë rast mund të supozohet se objektivat sektoriale janë mbështetëse dhe sinergjike me objektivat e PVMIM-së. (Kjo mund të kërkojë ende bashkëpunim të vazhdueshëm midis Bashkisë Durrës dhe institucioneve përkatëse kompetente për të siguruar rezultate të koordinuara).
- Anasjelltas, kur strategjia sektoriale nuk merr në konsideratë gjenerimin e mbetjeve ose trajtimin e tyre, por nuk shpjegon se si do të llogariten këto, qoftë në vetë strategjinë ose në VSM-në shoqëruese, atëherë pika theksohet **e kuqe ▼** dhe konsiderohet si rezultat negativ (-).

Interpretimi i rezultatit të ndikimit

Komponentët individualë përmbledhen për të siguruar një rezultat të thjeshtë total, me pikët jeshile që supozohen të jenë pozitive dhe rezultatet e kuqe supozohen të jenë negative. Prandaj, për çdo strategji specifike sektoriale, rezultati maksimal mund të jetë ose +6 ose -6.

Me fjalë të thjeshta, një rezultat -6 për sektorin specifik që vlerësohet do të tregonte se priten të ketë rreziqe shumë të rëndësishme për arritjen e të gjithë objektivave mjedisore të PVMIM-së dhe nuk është e qartë nga strategjia sektoriale se si do të menaxhohet këto rreziqe. Këto rreziqe mund të jenë përtej kontrollit të drejtpërdrejtë të kompetencave rregullatore të Bashkisë Durrës dhe për këtë arsye përbëjnë një kërcënim të mundshëm për zbatimin e suksesshëm të PVMIM.

Përpilimi i Ndikimeve Sektoriale kundrejt Objektivave Mjedisore

Referuar objektivave strategjike mjedisore të marrë në konsideratë në këtë raport paraprak të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, komponentët e identifikuar janë renditur më poshtë:

- Cilësia e ajrit
- Burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore)
- Toka dhe përdorimi i saj
- Biodiversiteti dhe ekosistemet
- Shëndeti publik
- Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë

Një matricë e rezultateve të ndikimit mjedisor nga secila prej strategjive ekonomike sektoriale të vlerësuara kundrejt secilit prej "objektivave të thjeshtuar mjedisor" (komponentët) është paraqitur nga tabelat 6-2 deri në 6-14. Çdo strategji sektoriale vlerësohet në thelb sipas "kredencialeve të saj mjedisore".

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Një pikë totale negative nuk tregon domosdoshmërisht se sektori do të ketë ndikime negative. Përkundrazi, tregon se praktika më e mirë sugjeron që zakonisht priten ndikime negative, por Strategjia (ose Raporti i VSM-së i saj) nuk i trajton apo përmend në mënyrë të kënaqshme këto ndikime nëpërmjet një politike, mase apo veprimi të përcaktuar lehtësues.

Nga kjo rrjedh se çdo rezultat negativ sugjeron vështirësi të mundshme në arritjen e objektivave strategjike mjedisore siç synohet nga PVMIM-ja dhe për këtë arsye pritet që sektori i veçantë duhet të komentojë në përputhje me rrethanat përmes procesit të konsultimit si pjesë e këtij vlerësimi të VSM-së.

Së fundi, me anë të një përmbledhjeje të përgjithshme, rezultatet sektoriale transferohen në një matricë të përgjithshme (Tabela 6-14), e cila paraqet rezultatet totale të ndikimit për sektorë të veçantë. Kjo qasje “ bazuar në rrezik” lehtëson një fokus të përqendruar në cilat objektiva mjedisore dhe nga cilët sektorë janë objektivat strategjike mjedisore të PVMIM-së (OSM) të ngjarë të mbështeten ose të komprometohen.

Ky rishikim i Kapitullit 6 dhe rishikimi specifik i Kapitullit 5 të Planit ofrojnë bazën e përmbajtjes së synuar të Kapitullit 8 – Veprimet Strategjike me Përparësi të Rekomanduara. Meqenëse ky është një Raport Paraprak i VSM-së, këto veprime dhe rekomandime janë në vetvete subjekt i shqyrtimit dhe komentimit nga palët e interesuara. Veprimet e finalizuara të preferuara dhe të miratuara më pas dokumentohen në Raportin Përfundimtar të VSM-së.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Tabela 6-1– Përmbledhje e politikave, planeve ose strategjive përkatëse ndërsektoriale

Sektori	Titulli i politikës, planit ose strategjisë	Autoriteti/Operatori Përgjegjës	VSM-ja e kryer	Çështjet përkatëse mjedisore
NDËR-SEKTORIAL	1. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT DHE INVESTIMEVE TË BIZNESIT, 2021–2027, DHE PLANI I VEPRIMIT (VKM nr. 466/2021)	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Nr	- Infrastruktura e grumbullimit, transportimit dhe menaxhimit të mbetjeve; - Tipologjitë e mbetjeve që gjenerohen nga individët dhe bizneset e Bashkisë Durrës; - Ndikimi i mbetjeve në trupat ujore të zonës, në rast të praktikave jo të mira të menaxhimit të mbetjeve; - Ndikimi në shëndetin publik.
	2. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR MENAXHIM TË INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE 2018-2027 (VKM nr. 73/2018)	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Nr	
MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA	1. DOKUMENTI I POLITIKËS STRATEGJIKE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE DHE PLANI KOMBËTAR	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Po	- Përputhshmëria e PVMIM me strategjinë dhe planin sektorial; - Ndikimi i mbetjeve në mjedisin e Bashkisë Durrës (ajër, ujëra sipërfaqësore e nëntokësore, tokë), në rast të praktikave jo të mira të menaxhimit të mbetjeve; - Emetimi i gazeve serrë; - Cilësia dhe zënia e tokës nga objektet e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve.
	2. PLANI SEKTORIAL KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	po	
NDRYSHIMET KLIMATIKE	1. DOKUMENTI STRATEGJIK DHE PLANET KOMBËTARE PËR REDUKTIMIN E GAZIT SERË DHE PËRSHTATJA KLIMATIKE (Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike) (VKM nr. 466/2019)	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore	Po	- Cilësia e ajrit; - Emetimi i gazeve serrë.
	2. PLANI KOMBËTARE I MENAXHIMIT TË CILËSISË SË AJRIT (VKM nr. 412/2019)	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë,	Nr	

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Sektori	Titulli i politikës, planit ose strategjisë	Autoriteti/Operatori Përgjegjës	VSM-ja e kryer	Çështjet përkatëse mjedisore
		Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Ujërve dhe i Turizmit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore		
ZHVILLIMI URBAN	1. PLANI I PËRGJITHSHËM KOMBËTAR (PPK) "SHQIPËRI 2030" (PLANI TERRITORIAL)		po	- Infrastruktura e grumbullimit, transportimit dhe menaxhimit të mbetjeve; - Ndikimi i mbetjeve në trupat ujore të zonës, në rast të praktikave jo të mira të menaxhimit të mbetjeve; - Ndikimi në shëndëtin publik; - Fragmentimi i habitateve dhe presioni mbi ekosistemet; - Tokat bujqësore dhe konkurrenca e përdorimit; - Rehabilitimi dhe rikthimi i tokës.
	2. PLAN I INTEGRUAR NDËRSEKTORIAL PËR ZONËN TIRANË-DURRËS		po	
	3. PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA DURRËS, miratuar 2022		po	
ZHVILLIMI I BREGDETIT DHE TURIZMI	1. PLANI KOMBËTAR I INTEGRUAR NDËRSEKTORIAL PËR BREGDETIN 2015 – 2030	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe të gjitha ministrisë dhe institucionet e tjera të ngarkuara me përgjegjësi nga plani	Po	- Ndikimi i mbetjeve në trupat ujore të zonës, në rast të praktikave jo të mira të menaxhimit të mbetjeve; - Ndikimi në shëndëtin publik; - Menaxhimi i burimeve natyrore (toka, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore)
	2. PLANI KOMBËTAR I TRANSPORTIT DETAR DHE INFRASTRUKTURËS PORTALE (Vendim KKT nr. 1, 2020)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Nr	
	3. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË TURIZMIT 2024-2030	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Nr	
BUJQËSIA + PYLLTARIA	1. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR UJTJE, DHE KULLIM 2019 – 2031 DHE PLAN VEPRIMI (VKM nr. 345/2019)	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural		- Ndikimi i mbetjeve në trupat ujore të zonës, në rast të praktikave jo të mira të menaxhimit të mbetjeve; - Menaxhimi i burimeve natyrore (toka, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore);
	2. STRATEGJIA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN RURAL DHE BUJQËSOR 2021-2027 (VKM NR. 460/2022)	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural		

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Sektori	Titulli i politikës, planit ose strategjisë	Autoriteti/Operatori Përgjegjës	VSM-ja e kryer	Çështjet përkatëse mjedisore
	3. STRATEGJIA KOMBËTARE PER KONSOLIDIMIN E TOKËS NË SHQIPËRI 2016-2030 (VKM nr. 700/2016)	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural		- Fragmentimi i habitateve dhe presioni mbi ekosistemet
INDUSTRIA + MINIERA + GURORET	1. DOKUMENTI STRATEGJIK I POLITIKAVE TË INDUSTRISE JO USHQIMORE (2016-2025) (i pa miratuar)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	- po	- Përdorimi i lëndëve të para dhe burimeve natyrore - Ndotja e ujërave dhe tokës - Mbetjet e rrezikshme - Ekonomia qarkulluese dhe riciklimi
PRODIMI I ENERGJISË	1. STRATEGJIA KOMBËTARE E ENERGJISË 2018–2030 (VKM nr. 480/2018)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	po	- Emetimi i gazeve serrë - Efikasiteti energjetik dhe ndikimi në klimë
	2. PLANI KOMBËTAR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ENERGJINË DHE KLIMËN 2020-2030 (VKM nr. 872/2021)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e përcaktuara në shtojcën 9 të dokumentit.		
FURNIZIMI PUBLIK ME UJË	1. PROGRAMI I SEKTORIT KOMBËTAR UJOR 2018-2030	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e përcaktuara në dokument	Nr	- Ndikimi i mbetjeve në trupat ujore të zonës, në rast të praktikave jo të mira të menaxhimit të mbetjeve; - Menaxhimi i burimeve natyrore (ujërat sipërfaqësore e nëntokësore)
UJËRAT E NDOTURA INDUSTRIALE	1. STRATEGJIA KOMBËTARE E FURNIZIMIT TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE, 2020-2030			
MBROJTJA NGA PËRMBYTJA	1. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR MENAXHIM TË INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE 2018-2027	AMBU	Nr	

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Strategjitë Ndërsektorale të Zhvillimit, Investimeve dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së

Nga Tabela 6-3, janë identifikuar 2 strategji kombëtare që lidhen me çështjet ndërsektorale të Zhvillimit, Investimeve ose Mbrojtjes së Mjedisit.

- **Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021–2027 dhe Plani i Veprimit**

Bazuar në një qasje koherente dhe të zbatueshme, Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve përbën orientimin kryesor të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin ekonomik afatmesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe në investime.

Qëllimi i politikës ndahet në tre objektiva:

- Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi
- Zhvillimi i NVM¹³-ve, sipërmarrja dhe inovacioni
- Zhvillimi i kapitalit njerëzor

dhe me një vizion të qartë: Një ekonomi konkurruese shqiptare, e drejtuar nga inovacioni dhe e bazuar në njohuri, e cila krijon vende pune të reja dhe cilësore, duke përfituar nga mundësitë që ofron transformimi dixhital dhe transformimi i zinxhirit ndërkombëtar të vlerës, me theksin në zhvillim të qëndrueshëm, integrim evropian dhe rajonal.

- **Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027.**

Objektivat strategjike përfshijnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, arritjen e cilësisë së mirë të ujit në të gjitha burimet ujore deri në vitin 2027, reduktimin dhe menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë për thatësinë dhe përmbytjet, rritjen e njohurive të qëndrueshme shkencore mbi çështjet e ujit dhe klimës dhe aplikimin e praktikave gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të menaxhimit të ujit.

Vlerësimi i Ndikimit Sektorial

Tabela 6-4 përmbledh rishikimin objektiv të strategjive ndërsektorale të publikuara të investimeve, zhvillimit ose mbrojtjes së mjedisit. Strategjia vlerësohet në bazë të një liste kontrolli të komponentëve kyç mjedisorë. Nëse pritet që strategjia zakonisht do të ndikojë negativisht në ndonjë nga komponentët e listuar, ai komponent është shënuar negativisht si parazgjedhje. Megjithatë, çdo përmendje e ndonjë prej gjashtë komponentëve në strategji,

¹³ Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

duke u njohur si “një çështje”, ose që kërkon pajtueshmëri dhe/ose veprime korrigjuese është e mjaftueshme për të kthyer rezultatin negativ në një rezultat pozitiv.

- **Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021–2027, dhe Plani i Veprimit**

Nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me PVMIM-në, por ka disa masa ose objektiva të përgjithshme që lidhen me zhvillimin e bizneseve inovative të gjelbra ose ekonomisë së gjelbër dhe rrethore.

Në këtë strategji parashikohet të krijohen zona të lira dhe parqe industriale (TEDA¹⁴), por nuk parashikohet që gjatë krijimit të tyre të merret në konsideratë mbrojtja e burimeve natyrore, përfshirë ndotjen nga mbetjet, ose distanca nga Zonat e Mbrojtura etj.

Cilësia e ajrit: nuk merret në konsideratë në dokument

Burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore) : nuk merret në konsideratë në dokument

Toka dhe përdorimi i saj: nuk merret në konsideratë në dokument

Biodiversiteti dhe ekosistemet: nuk merret në konsideratë në dokument

Shëndeti publik: nuk merret në konsideratë në dokument

Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë: nuk merret në konsideratë në dokument

- **Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027.**

Ky dokument ka një objektiv strategjik, i cili ka të bëjë me sasinë e ujit dhe rrjedhimisht me shpërndarjen e ujit ndërmjet përdoruesve. Menaxhimi i burimeve mbetje në nivel baseni kërkon kapacitetet për të përgatitur dhe zbatuar Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujore për përmirësimin e infrastrukturës së shpërndarjes së ujit dhe marrjen e masave të ruajtjes.

Një objektiv tjetër strategjik i këtij dokumenti ka të bëjë me cilësinë e ujit, i cili ndikon në përdorimin e ujit dhe si i tillë ka ndikime socio-ekonomike.

Cilësia e ajrit: nuk merret në konsideratë në dokument

Burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore): Përfshihen me masa konkrete në Programin e Buxhetit (vlerësimi i dëmtimeve nga mbetjet)

Toka dhe përdorimi i saj: Përfshin masa për erozionin në zonat bregdetare, por jo specifikisht në fushën e menaxhimit të mbetjeve (pra zënia e tokës për ndërtimin e objekteve për menaxhimin e mbetjeve)

Biodiversiteti dhe ekosistemet: Janë trajtuar në funksion të burimeve ujore.

Shëndeti publik: nuk merret në konsideratë në dokument

¹⁴ zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë: Ndryshimet klimatike janë të lidhura me burimet ujore dhe jo me shkarkimet e gazit metan që vijnë nga mbetjet urbane.

- Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve ujore
 - PVMIM parashikon reduktimin e ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga mbetjet urbane dhe depozitimet e pakontrolluara.
 - Bashkia Durrës, duke zbatuar menaxhimin e integruar të mbetjeve (ndarje në burim, riciklim, reduktim i mbetjeve organike), kontribuon drejtpërdrejt në ruajtjen e burimeve ujore nga kontaminimi.
- Arritja e cilësisë së mirë të ujit deri në vitin 2027
 - Strategjia synon që lumenjtë, liqenet, uji nëntokësor dhe uji bregdetar të jenë me cilësi të mirë.
 - PVMIM ndihmon duke reduktuar shkarkimet e paligjshme të mbetjeve urbane dhe industriale që sot përbëjnë një burim ndotjeje për ujërat e Durrësit, veçanërisht për lumin Erzen, lumin Ishëm dhe vijën bregdetare.
- Reduktimi dhe menaxhimi i rrezikut nga përmbytjet dhe thatësitrat
 - Depozitimet e mbetjeve në shtratin e lumenjve dhe kanaleve kulluese rrisin rrezikun e përmbytjeve.
 - Zbatimi i PVMIM dhe parandalimi i hedhjes së mbetjeve në lumenj/kanale kontribuon në menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet.
 - Përmes bashkëpunimit ndërinstitutional, strategjia e ujërave dhe plani vendor i mbetjeve krijojnë një mekanizëm të integruar për reduktimin e fatkeqësive natyrore.
- Praktikrat gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të menaxhimit
 - Strategjia e ujërave dhe PVMIM kanë qasje të ngjashme: pjesëmarrjen e publikut, edukimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit, si dhe përfshirjen e bizneseve në zgjidhje të qëndrueshme.
 - Kjo sinergji e bën më efektiv zbatimin e të dy dokumenteve dhe krijon koherencë me standardet e Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së dhe Direktivës së Mbetjeve.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Tabela 6-2– Strategjitë Ndërsektorale të Zhvillimit, Investimeve dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Komponenti Mjedisor Strategjia ose Programi	Cilësia e ajrit	Burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore)	Toka dhe përdorimi i saj	Biodiversiteti dhe ekosistemet	Shëndeti publik	Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë
Parazgjedhjet	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021–2027, dhe Plani i Veprimit	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027	▼	▼	▲	▲	▼	▼
Rezultati i ndikimit sipas komponentit	-3	-3	-1	-1	-3	-3

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Planifikimi dhe Zhvillimi Urban

Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së

Nga Tabela 6-3, janë identifikuar 7 strategji/plane kombëtare në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin urban.

- **Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK), Shqipëri 2030**

PPK-ja përfaqëson një qasje të integruar të qëndrueshme ndaj zhvillimit urban, me sektorë të tjerë strategjikë të vendit si turizmi, bujqësia, energjia, transporti, strehimi dhe aspekte të tjera. Disa nga objektivat kryesore të planit janë administrimi i rrezikut të përmytjeve dhe erozionit të vijës bregdetare dhe inkurajimi i ripërdorimit të burimeve ekzistuese.

Objektivat e PPK-së:

- Promovon kohezionin territorial nëpërmjet zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social rajonal dhe rrit konkurrencën.
- Mbështet zhvillimin e krijuar nga funksionet e përziera urbane dhe përmirëson marrëdhëniet midis zonave urbane dhe rurale.
- Promovon aksesueshmërinë.
- Rrit aksesin në njohuri dhe informacion.
- Redukton dëmtimet mjedisore.
- Mbron dhe forcon burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore, (duke iu referuar ligjit nr.9048, datë 04.07.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar.
- Rrit trashëgiminë kulturore si faktor zhvillimi.
- Zhvillon burimet e energjisë, duke ruajtur sigurinë.
- Promovon turizmin cilësor dhe të qëndrueshëm.
- Kufizon ndikimin e fatkeqësive natyrore.

- **Plani i Integruar Ndërsektorial i Zonës Tiranë – Durrës**

Plani i Integruar Ndërsektorial i zonës ekonomike Tiranë-Durrës është hartuar me qëllim krijimin e një kuadri orientues për zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit dhe synimin për arritjen e vizionit të tij të parashikuar deri në vitin 2030. Ky është një dokument strategjik i krijuar për tu shërbyer institucioneve përkatëse për të drejtuar zhvillimet në zonë dhe për të mobilizuar investimet kapitale si dhe vetë kapitalin njerëzor. Mjetet nëpërmjet të cilave PINS Tiranë-Durrës operon për të arritur vizionin dhe objektivat strategjikë janë politikat e zhvillimit rajonal dhe projektet përkatëse brenda çdo politike zhvillimore.

Objektivat strategjikë të këtij plani janë renditur më poshtë:

- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
- Përmirësimi i cilësisë së jetës në qendrat urbane dhe rurale;
- Përmirësimi i infrastrukturës, transportit dhe lëvizshmërisë në rajon;

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

- Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit natyror.

Politikat e zhvillimit të mjedisit:

Plani i Integruar Ndërsektorial i zonës ekonomike Tiranë-Durrës përmban disa Politika të Zhvillimit Mjedisor që trajtojnë problematikat e njohura mjedisore në këtë qark, pjesë e të cilave është edhe baseni i lumit Ishëm. Këto politika janë përmendur më poshtë:

- Ruajtja e peizazhit natyror (trashëgimia natyrore dhe mjedisore).
- Mbrojtja dhe menaxhimi i burimeve mbetje sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- Infrastruktura e gjelbër.
- Menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.
- Menaxhimi rajonal i mbetjeve.
- Ndryshimi i klimës.
- Monitorimi i cilësisë së mjedisit.

• Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Durrës

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë së Durrësit përcakton kufijtë e zhvillimit urban, duke marrë në konsideratë të dhënat e menaxhimit hapësinor, polet ekonomike ekzistuese dhe të parashikuara, zhvillimin ekzistues dhe të ardhshëm infrastrukturor dhe atraksionet turistike, kulturore dhe peizazhore.

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 671/ 29.7.2016 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, gjatë hartimit të një Plani të Përgjithshëm Vendor, territori i bashkisë ndahet në 5 sisteme hapësinore:

- 1- Sistemi urban;
- 2- Sistemi natyror;
- 3- Sistemi bujqësor;
- 4- Sistemi i ujit;
- 5- Sistemi infrastrukturor.

Janë 2 objektiva strategjike natyrorë të përfshirë në PPV-në e Bashkisë Durrës, të cilat përmenden më poshtë:

- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban;
- Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Plani përfshin gjithashtu një seksion ndërsektorial, ku planet përkatëse ndihmojnë në arritjen e objektivave të përmendura strategjike natyrore të PPV-së.

Vlerësimi i Ndikimit Sektorial

Tabela 6-5 përmbledh rishikimin objektiv të strategjive të publikuara të Planifikimit dhe Zhvillimit Urban. Strategjia vlerësohet në bazë të një liste kontrolli të komponentëve kyç mjedisore. Nëse pritet që strategjia zakonisht do të ndikojë negativisht në ndonjë nga komponentët e listuar, ai komponent është shënuar negativisht si parazgjedhje. Megjithatë, çdo përmendje e ndonjë prej gjashtë komponentëve në strategji, duke u njohur si “një çështje”,

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

ose që kërkon pajtueshmëri dhe/ose veprime korigjuese është e mjaftueshme për të kthyer rezultatin negativ në një rezultat pozitiv.

- **Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK), Shqipëri 2030**

PPK-ja përmend zonën Tiranë – Durrës si motorin e ekonomisë së vendit, me prioritet kryesor njohuritë dhe investimet e fokusuara në inovacion dhe teknologji, por nuk ka asnjë analizë të 5 sistemeve territoriale krahasuar me polet e tjera të zhvillimit rajonal. Ky plan përfshin masa zbutëse në nivel kombëtar dhe lokal për të adresuar ndryshimet klimatike (p.sh. përmytjet). Megjithatë, këto masa janë të përgjithshme dhe jo shumë specifike, për sa i përket përcaktimit të qëllimeve të përshtatura për një fushë të caktuar.

Nga ana tjetër, PPK-ja përfshin shumë masa që ndikojnë pozitivisht në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (të cilat në mënyrë indirekte janë të lidhura me PVMIM-në):

Spektori i ujit: rehabilitimi, zgjerimi dhe krijimi i infrastrukturës për furnizimin me ujë duke përfshirë skenarët e ndryshimeve klimatike në këtë spektor. Menaxhimi i kërkesës për ujë nëpërmjet ripërdorimit, sigurimit të rezervave të reja mbetje, ujërave të shiut, shkripëzimit etj.

Spektori i bujqësisë: përmirësimi i efikasitetit të ujit, infrastrukturës së ujitjes, varieteteve të bimëve, sistemit të kullimit, plehërimit dhe ruajtjes së lagështisë së tokës duke marrë parasysh ndikimet e rritjes së temperaturës për shkak të ndryshimeve klimatike.

Bregdeti: monitorimi i dinamikës së vijës bregdetare dhe nivelit të detit; monitorimi i cilësisë së ujit në ligatinat dhe ujërat nëntokësore; menaxhimi e erozionit bregdetar si dhe masat e përshtatjes për të përballuar rritjen e pritshme të nivelit të detit.

Cilësia e ajrit: Është përmendur si objektiv lidhur me sistemin natyror, gjithashtu edhe si sugjerim *“ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve të lëngëta urbane dhe industriale, për të zvogëluar sasinë e lëndëve ndotëse në mjediset ujore, tokësore dhe ajrore”*.

Burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore): Është përmendur si objektiv lidhur me sistemin natyror, gjithashtu edhe si sugjerim *“ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve të lëngëta urbane dhe industriale, për të zvogëluar sasinë e lëndëve ndotëse në mjediset ujore, tokësore dhe ajrore”*.

Toka dhe përdorimi i saj: Është përmendur si objektiv lidhur me sistemin natyror, gjithashtu edhe si sugjerim *“ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve të lëngëta urbane dhe industriale, për të zvogëluar sasinë e lëndëve ndotëse në mjediset ujore, tokësore dhe ajrore”*.

Biodiversiteti dhe ekosistemet: Zonat e mbrojtura dhe pyjet janë përmendur sistemin natyror, por jo drejtpërdrejt të lidhur me mbetjet.

Shëndeti publik: Është përmendur në plan, por jo i lidhur drejtpërdrejt me mbetjet.

Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë: Është përmendur në plan, por jo i lidhur drejtpërdrejt me mbetjet.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

• Plani i Integruar Ndërsektorial i Zonës Tiranë – Durrës

Në këtë dokument renditen disa politika të zhvillimit mjedisor, si: ruajtja e peizazhit natyror (trashëgimia natyrore dhe mjedisore); menaxhimi i mbetjeve; infrastruktura e gjelbër; menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore; monitorimi i cilësisë së mjedisit.

Cilësia e ajrit: Është e përfshirë në Politikën e Zhvillimit Mjedisor

Burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore): Është e përfshirë në Politikën e Zhvillimit Mjedisor

Toka dhe përdorimi i saj: Është i përfshirë në Politikën e Zhvillimit Mjedisor, gjithashtu është trajtuar si çështje toka në funksion të objekteve të menaxhimit të mbetjeve.

Biodiversiteti dhe ekosistemet: Është i përfshirë në Politikën e Zhvillimit Mjedisor

Shëndeti publik: Është i përfshirë në Politikën e Zhvillimit Mjedisor,

Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë: Është i përfshirë në Politikën e Zhvillimit Mjedisor, por jo në funksion të mbetjeve

• Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Durrës

Cilësia e ajrit: Trajtuar shkurtimisht në raport, jo në funksion të menaxhimit të mbetjeve.

Burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore): Trajtuar shkurtimisht në raport, jo në funksion të menaxhimit të mbetjeve.

Toka dhe përdorimi i saj: Trajtuar shkurtimisht në raport, jo në funksion të menaxhimit të mbetjeve.

Biodiversiteti dhe ekosistemet: Trajtuar shkurtimisht në raport, jo në funksion të menaxhimit të mbetjeve.

Shëndeti publik: Trajtuar shkurtimisht në raport, jo në funksion të menaxhimit të mbetjeve.

Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë: Nuk janë trajtuar në plan.

Tabela6-3– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit Urban

Komponenti Mjedisor Strategjia ose Programi	Cilësia e ajrit	Burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore)	Toka dhe përdorimi i saj	Biodiversiteti dhe ekosistemet	Shëndeti publik	Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë
Parazgjedhjet	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Shqipëri 2030	▲	▲	▲	▼	▼	▼
Plani i Integruar Ndërsektorial i Zonës Tiranë – Durrës	▲	▲	▲	▲	▲	▼
Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Durrës	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Rezultati i ndikimit sipas komponentit	0	0	0	-2	-2	-4

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta

Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së

Nga tabela 6-3,2 strategjitë kombëtare janë identifikuar në lidhje me menaxhimin e mbetjeve të ngurta.

- **Dokumenti i Politikës Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar 2020-2035**

Strategjia është dokumenti kryesor në fushën e menaxhimit të mbetjeve bashkiake, jobashkiake dhe të rrezikshme në Shqipëri.

Dokumenti i Politikës Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar është një nga dokumentet më të rëndësishme dhe thelbësore në fushën e mbetjeve që synon kalimin nga një ekonomi lineare në një ekonomi rrethore.

Objektivat specifike të Dokumentit të Politikës Strategjike synojnë të ofrojnë zgjidhje praktike për:

1. adresimi i problemeve në sistemin aktual të menaxhimit,
2. zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe,
3. përgatitjet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve nga ndryshimet në direktivat e BE-së, përfshirë objektivat ambicioze të Paketës së Ekonomisë Rrethore.

Nëpërmjet zbatimit të Dokumentit të Politikës Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Planit Kombëtar synohet të arrihet Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 14.1 “Reduktimi i ndotjes detare: Deri në vitin 2025, parandalimi dhe zvogëlimi i ndjeshëm i ndotjes detare të të gjitha llojeve, veçanërisht nga aktivitetet me bazë tokësore, duke përfshirë mbeturinat detare dhe ndotja e lëndëve ushqyese.”

- **Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta**

Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta është i orientuar nga objektivat e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, kryesisht në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme për mbetjet e ngurta komunale në të gjithë vendin, reduktimin dhe riciklimin e fraksioneve të mbetjeve, uljen e numrit të venddepozitimeve të pakontrolluar dhe landfillet josanitare, si dhe për mbrojtjen e mjedisit.

Vlerësimi i Ndikimit Sektorial

Tabela 6-14 përmbledh rishikimin objektiv të strategjisë së publikuar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

- Dokumenti i Politikës Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar 2020-2035**

Megjithëse ky dokument është një nga dokumentet më të rëndësishme në nivel kombëtar që trajton menaxhimin e mbetjeve, ai nuk merr në konsideratë çështjet mjedisore që rezultojnë nga praktikat jo të duhura të menaxhimit të mbetjeve, prandaj nuk përfshin asnjë masë specifike që duhet marrë për të shmangur ose zbutur / rikuperoni cilësinë e ujit.

Baseni i lumit Erzen është i ndotur nga burime të shumta dhe mbetjet e ngurta janë një prej tyre. Mbetjet e ngurta që hidhen në lumenj ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ujit, hidrobiologjinë dhe cilësinë e jetës mbetje, mbetjet inerte ndikojnë drejtpërdrejt në morfologjinë e trupave mbetje dhe regjimin e rrjedhës së lumit (në rast se mbetjet e ngurta grumbullohen). Për më tepër, këto mbetje të ngurta transportohen më pas në det.

Cilësia e ajrit: Nuk trajtohet në dokument

Burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore): Është përfshirë te “Objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm (OZHQ) të OKB dhe ekonomia qarkulluese”

Toka dhe përdorimi i saj: Nuk trajtohet në dokument

Biodiversiteti dhe ekosistemet: Nuk trajtohet në dokument

Shëndeti publik: Nuk trajtohet në dokument

Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë: Nuk trajtohet në dokument

- Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta**

Në dokument trajtohen kryesisht metodat e trajtimit të mbetjeve të ngurta, efektet negative që shkaktohen nga keqmenaxhimi i mbetjeve, por jo masa konkrete për reduktimin ose rikuperimin e këtyre efekteve.

Cilësia e ajrit: Nuk trajtohet në dokument

Burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore): Nuk trajtohet në dokument

Toka dhe përdorimi i saj: Nuk trajtohet në dokument

Biodiversiteti dhe ekosistemet: Nuk trajtohet në dokument

Shëndeti publik: Nuk trajtohet në dokument

Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë: Nuk trajtohet në dokument

Tabela6-4– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta

Komponenti Mjedisor Strategjia ose Programi	Cilësia e ajrit	Burimet ujore (sipërfaqësore e dhe nëntokësore)	Toka dhe përdorimi i saj	Biodiversiteti dhe ekosistemet	Shëndeti publik	Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë
parazgjedhjet	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Dokumenti i Politikës Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar	▼	▲	▼	▼	▼	▼
Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Rezultati i ndikimit nga komponenti	-3	-2	-3	-3	-3	-3

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Zhvillimi bregdetar dhe Turizmi

Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së

Nga Tabela 6-3, janë identifikuar 3 strategji/plane kombëtare në lidhje me zhvillimin bregdetar dhe turizmin.

- **Plani Kombëtar i Integruar Ndërsektorial për Vijën Bregdetare 2015 – 2030**

Ky plan synon gjithashtu të krijojë një marrëdhënie më të mirë midis kërkesave për investime private dhe zhvillimit të qëndrueshëm territorial, në mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë historike, kulturore, të zonave të mbrojtura të natyrës dhe njëkohësisht në parandalimin e disa investimeve në zonat që konsiderohen si të rrezikshme për jetën, natyrën dhe mjedisin.

Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i sistemeve mbetje dhe natyrore është një nga vizionet e këtij plani, në të cilin përfshihen disa objektiva në lidhje me ZM-të, ekosistemet natyrore dhe sistemet mbetje gjithashtu.

- **Plani Kombëtar i Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portale**

Ky plan u miratua në zbatim të Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit, në përmbushje të detyrimeve sektoriale në fushën e planifikimit të territorit, por mbi të gjitha për t'i paraprirë zhvillimit të mundshëm dhe të nevojshëm të sektorit të transportit detar, i cili lidhet me shumë sektorë të ekonomisë së vendit, si tregtia, transporti në tërësi, përpunimi i lëndëve të para, turizmi dhe zhvillimi urban.

Objektivat strategjike:

- Zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës detare dhe integrimi me rrjetet alternative të transportit.
- Zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomisë portuale nëpërmjet rivitalizimit, zgjerimit, diversifikimit dhe specializimit të zonave portuale.
- Uji dhe Mbrojtja e Mjedisit.

Vlerësimi i Ndikimit Sektorial

Tabela 6-6 përmbledh rishikimin objektiv të strategjive për zhvillimin bregdetar dhe të turizmit. Strategjia vlerësohet në bazë të një liste kontrolli të komponentëve kyç mjedisorë. Nëse pritet që strategjia zakonisht do të ndikojë negativisht në ndonjë nga komponentët e listuar, ai komponent është shënuar negativisht si parazgjedhje. Megjithatë, çdo përmendje e ndonjë prej gjashtë komponentëve në strategji, duke u njohur si “një çështje”, ose që kërkon pajtueshmëri dhe/ose veprime korrigjuese është e mjaftueshme për të kthyer rezultatin negativ në një rezultat pozitiv.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

- Plani Kombëtar i Integruar Ndërsektorial për Vijën Bregdetare 2015 – 2030**

Prioriteti për çdo njësi të qeverisjes vendore që ka akses në det, ose që ka burime të tjera mbetje, duhet të jetë mirëmenaxhimi i integruar i burimeve mbetje, ku thelbësore mbeten masat specifike të marra për përmirësimin e sistemeve të trajtimit të ujërave të ndotura. Konkluzion i këtij dokumenti dhe rekomandim gjithashtu.

Ky plan synon rritjen e zonave të mbrojtura mjedisore dhe rritjen e kategorisë së statusit të mbrojtjes së tyre.

Cilësia e ajrit: Është e përfshirë në Politikat e Zhvillimit Mjedisor

Burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore): Është e përfshirë në Politikat e Zhvillimit Mjedisor

Toka dhe përdorimi i saj: Është i përfshirë në Politikat e Zhvillimit Mjedisor, gjithashtu është trajtuar si çështje toka në funksion të objekteve të menaxhimit të mbetjeve.

Biodiversiteti dhe ekosistemet: Është i përfshirë në Politikat e Zhvillimit Mjedisor

Shëndeti publik: Është i përfshirë në Politikat e Zhvillimit Mjedisor

Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë: Është i përfshirë në Politikat e Zhvillimit Mjedisor, por jo në funksion të mbetjeve

- Plani Kombëtar i Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale**

Në kuadër të objektivit “Mbrojtja e Ujit dhe Mjedisit”, është parashikuar programi “Monitorimi i veprimtarisë portuale për mbrojtjen e ujit dhe mjedisit”, i cili është në përputhje me objektivat e PVMIM-së.

Cilësia e ajrit: Nuk trajtohet në dokument

Burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore): Nuk trajtohet në dokument

Toka dhe përdorimi i saj: Nuk trajtohet në dokument

Biodiversiteti dhe ekosistemet: Nuk trajtohet në dokument

Shëndeti publik: Nuk trajtohet në dokument

Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë: Nuk trajtohet në dokument

Tabela6-5– Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis – Zhvillimi Bregdetar & Turizmi

Komponenti Mjedisor Strategjia ose Programi	Cilësia e ajrit	Burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore)	Toka dhe përdorimi i saj	Biodiversiteti dhe ekosistemet	Shëndeti publik	Ndryshimet klimatike dhe emetimet e gazeve serrë
Parazgjedhjet	▼	▼	▼	▼	▼	▼
PLANI KOMBËTAR I INTEGRUAR NDËRSEKTORIAL PËR VIJEN BREGDETARE 2015 – 2030	▲	▲	▲	▲	▲	▼
PLANI KOMBËTAR I TRANSPORTIT DETAR DHE INFRASTRUKTURËS PORTUALE	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Rezultati i ndikimit sipas komponentit	-1	-1	-1	-1	-1	-3

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Infrastruktura e Transportit

Pasqyrë e Strategjive Sektoriale dhe Rëndësia me Objektivat Mjedisore të PVMIM-së

Nga tabela 6-3,3 strategji/plane kombëtare janë identifikuar në lidhje me infrastrukturën e transportit.

- **Rishikimi i Dytë Pesëvjeçar i Planit Kombëtar të Transportit Shqiptar (PKTSh3) (Draft)**

Objekti i përgjithshëm i Rishikimit të Dytë Pesëvjeçar të Planit Kombëtar të Transportit Shqiptar (PKTSh3) është "të rrisë zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë, i nxitur nga një sektor transporti efikas brenda një kuadri politikash gjithëpërfshirëse". Megjithatë ky dokument PKTSh3 është një përditësim i drejtpërdrejtë i PKTSh2, prioritetet strategjike të përcaktuara në Strategjinë e Transportit 2016-2020 janë adresuar dhe përbëjnë pikënisjen për zhvillimin e veprimeve me përparësi për periudhën e ardhshme të planifikimit 20-vjeçar.

PKTSh-ja ka zhvilluar një sërë objektivash apo synimesh kryesore qeverisëse dhe një prej tyre është krijimi i një sistemi transporti të qëndrueshëm për mjedisin, por gjithsesi, ky objektivi përmendet vetëm shkurt, pa u detajuar.

- **Plani i Transportit të Qëndrueshëm**

Plani është një dokument që ndihmon Ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën në arritjen e kursimeve të pritshme të energjisë në sektorin e transportit në Shqipëri, duke mbuluar objektivat e mëposhtëm:

- Kuantifikimi i niveleve të kaluara, aktuale dhe të parashikuara të përdorimit të energjisë dhe ndotjes së gazeve serrë (GS) sipas mënyrës së transportit, duke iu referuar të dhënave aktuale.
Në përmbledhje, PVMIM i Bashkisë Durrës është i ndërtuar mbi një kornizë të konsoliduar ligjore kombëtare dhe është në përputhje me kërkesat ndërkombëtare, duke siguruar që monitorimi, raportimi dhe verifikimi të shërbejnë si mekanizëm i dyfishtë: një instrument menaxhimi vendor dhe një garanci për përafrimin e Shqipërisë me standardet e BE-së.

7.1.1 Niveli Kombëtar – Ligji 91/2013 dhe Ligji 111/2012

Sipas Ligjit të Republikës së Shqipërisë nr. 91/2013 (neni 10) është një kërkesë që të përshkruhen masat e parashikuara për monitorimin e pasojave në mjedis gjatë zbatimit të Planit. (Kjo klauzolë supozon në mënyrë absolute se Plani mund/do të ketë ndikime negative mjedisore pa masa zbutëse dhe për pasojë ndikimet duhet të monitorohen).

Duhet theksuar se sipas Nenit 12 të Ligjit 10463/2012, “Raportimi” është një kërkesë e rëndësishme ligjore, ku citohet se *“5. Çdo njësi e qeverisjes vendore raporton çdo vit në këshillin e qarkut përkatës për zbatimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve në formatin e përcaktuar nga ministri.”*

7.1.2 Niveli i BE-së – Direktiva 2001/42/EC

Ligji 91/2013 (neni 10) harmonizohet me kërkesat e Direktivës së BE-së 2001/42/KE (neni 10) e cila udhëzon që Shtetet Anëtare të monitorojnë efektet e rëndësishme mjedisore të zbatimit të planeve dhe programeve në mënyrë që, ndër të tjera, të identifikojnë në një fazë të hershme efektet negative të parashikuara dhe të jenë në gjendje të ndërmarrin veprimet e duhura korrigjuese.

7.1.3 Niveli i BE-së – Korniza e 8-të e Monitorimit të PVM-së

Komisioni Evropian ka përgatitur një kornizë monitorimi me tregues kryesorë për Programin e 8-të të Veprimit për Mjedisin (PVM), siç është shpallur në Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane (MGjE). Propozimet për Programin e 8-të të Veprimit për Mjedisin (PVM-ja e 8-të) përfshijnë skicën për një mekanizëm monitorues për të matur progresin e BE-së drejt objektivave të saj klimatike dhe mjedisore.¹⁵

Politikat e klimës dhe mjedisit duke qenë në qendër të MGjE-së, ekziston nevoja për të matur progresin në një mënyrë gjithëpërfshirëse drejt objektivave mjedisore dhe klimatike të Bashkimit për qëllimin e komunikimit politik strategjik.

¹⁵https://environment.ec.europa.eu/neës/stakeholder-workshop-8th-eap-monitoring-framework-2021-09-21_en

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës




Figura7-1– Arkitektura e Kornizës së 8-të të Monitorimit të PVM-së

Figura 7-1 ilustron se grupi i 8-të i treguesve të PVM-së do të bazohet në “monitorimin tematik”, qoftë ekzistues (siç është qeverisja e klimës dhe energjisë) ose kornizat monitoruese në zhvillim (si p.sh. për ndotjen zero dhe biodiversitetin) ose nën përditësim (ekonomia rrethore).

Sikurse vihet re dhe nga figura e mësipërme, indikatorët e përcaktuar nga Programi i Veprimit të Mjedisit janë:

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

- 1- Zbutja ndaj ndikimeve klimatike;
- 2- Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike;
- 3- Ekonomi rrethore regjenerative;
- 4- Ndotje zero dhe mjedis pa toksicitet;
- 5- Biodiversiteti dhe ekosistemet;
- 6- Presionet mjedisore dhe klimatike të lidhura me prodhimin dhe konsumin në BE;
- 7- Kushtet mundësuese;
- 8- Të jetuarit mirë, brenda kufijve të planetit.

Udhëzimet e Rregullores më të Mirë¹⁶ gjithashtu sugjerojnë që kornizat e monitorimit duhet të jenë në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Mblidhni vetëm informacionin që është i rëndësishëm për të minimizuar barrën administrative;
- Automatizoni sa më shumë që të jetë e mundur me përdorimin e mjeteve të Teknologjisë së Informacionit për të shkurtuar kohën e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave;
- Përdorni standarde të përbashkëta raportimi për të rritur ndërveprimin dhe për të lehtësuar ndarjen e të dhënave në kontekstin e fushave të ndryshme të politikave;
- Përdorni maksimalisht të dhënat ekzistuese për të kursyer kohë dhe për të rritur koherencën e rezultateve;
- Jini transparent ndaj palëve të interesuara dhe zgjidhni t'i bëni të dhënat publike, mundësisht si "të dhëna të hapura".

Shmangia e Dyfishimit të Monitorimit

Megjithatë, planet e menaxhimit të mbetjeve janë kryesisht plane të menaxhimit dhe monitorimit mjedisor, përputhshmëria mjedisore e Planit matet kryesisht nga objektivat mjedisore të përcaktuar brenda vetë Planit.

Rrjedhimisht, të njëjtat procedura monitorimi dhe raportimi të kërkuara për progresin e PVMIM mund të përdoren si pjesë e procesit të monitorimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Megjithatë, për të shmangur kompleksitetin e tepërt në nivelin strategjik, është e arsyeshme të thjeshtësohet numri potencialisht shumë i madh i kërkesave të monitorimit dhe raportimit të PVMIM në një numër më të vogël të thjeshtuar tregues të “nivelit të lartë”. Treguesi i reduktuar i

¹⁶https://ec.europa.eu/info/laë/laë-making-process/planning-and-proposing-laë/better-regulation-ëhy-and-hoë/better-regulation-guidelines-and-toolbox_en

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

vendosur në nivel VSM-je duhet të ofrojë një pasqyrë përfaqësuese të gjendjes së mjedisit në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në përgjithësi, por megjithatë nuk kërkon monitorim shtesë.

Parametrat e dhura të thjeshtuara dhe treguesit e tyre për t'u monitoruar në nivel VSM-je është subjekt i pjesës së mbetur të Kapitullit 7.

Treguesit e Monitorimit

Gjendja dhe tendencat

Treguesit mjedisorë luajnë një rol vendimtar për politikëbërjen efektive dhe koherente duke theksuar faktorët kryesorë në modelin nxitës-presion-gjendje-ndikim-përgjigje (NPGjNP) që shkaktojnë presione mjedisore dhe që politika mund të synojë.¹⁷Treguesit mbështesin vlerësimet teknike duke ofruar informacion mbi gjendjet dhe tendencat e çështjeve me përparësi dhe përparimin drejt objektivave ose vlerave të referencës. Prandaj, treguesit sasiorë janë një mjet kyç i menaxhimit dhe përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të mangësive në arritjen e statusit ose potencialit të mirë dhe përparimin e synuar brenda një afati të caktuar.

Në nivelin e VSM-së, është e nevojshme vetëm përdorimi i treguesve të shkallës së gjerë që konfirmojnë gjendjen e mundshme të përgjithshme të mjedisit në varësi të politikave të menaxhimit të mbetjeve.

Rëndësia dhe Përputhshmëria e Politikave

Treguesit, qofshin të aplikuar në nivel PVMIM ose VSM-je, janë thelbësorë për të siguruar që objektivat e politikave afatgjata janë arritur. Treguesit janë krijuar për të mbështetur të gjitha fazat e bërjes së politikave mjedisore, nga hartimi i kornizave të politikave deri te vendosja e objektivave dhe nga monitorimi dhe vlerësimi i politikave deri te komunikimi me politikëbërësit dhe publikun. Më e rëndësishmja, treguesit tregojnë nëse objektivat e politikës shoqëruese janë përmbushur apo jo dhe objektivat sasiorë janë arritur.¹⁸

Prandaj, kuadri i raportimit duhet të përcaktojë qartë dhe të tregojë:

- a) vlerat bazë në fillim të planit
- b) vlerat e synuara në fund të planit
- c) vlerat afatmesme për të treguar tendencën e përputhshmërisë.

17Agjencia Evropiane e Mjedisit - Përmbledhja e treguesve të EEA 2014 – Raporti Teknik 8/2014.

18Agjencia Evropiane e Mjedisit -<https://www.eea.europa.eu/ims>

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Korniza e propozuar e monitorimit të VSM-së

Në përputhje me “temat” e objektivit strategjik mjedisor të Tabelës 3-2, dhe natyrën tematike të propozuar të PVM-së së 8-të të BE-së (Figura 7-1), treguesit e nivelit të lartë janë përzgjedhur për të përfaqësuar secilin prej këtyre objektivave tematikë të politikës:

OSM1 – Ndryshimi i klimës;

OSM2 – Mbrojtja e ujërave sipërfaqësor;

OSM3 – Mbrojtja e ujërave nëntokësore;

OSM6 – Habitatet & Zonat e Mbrojtura;

OSM7 – Tokat dhe burimet tokësore 38

OSM8 – Menaxhimi bregdetar

Agjencitë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave

Bashkia Durrës si Autoriteti propozues i Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve ka përgjegjësinë përfundimtare për të mbledhur dhe raportuar mbi statusin e zbatimit të masave të propozuara dhe gjithashtu nivelin e përputhshmërisë me objektivat strategjike mjedisore (VSM).

Bashkia Durrës nuk mbledh në mënyrë rutinore të dhëna mjedisore dhe do të kërkojë që këto të dhëna të mbledhen nga operatorët menaxhues të objekteve të grumbullimit, transportimin e menaxhimit të mbetjeve. Këto detaje ende duhet të bien dakord ndërmjet palëve përkatëse të interesit.

Institucionet ku raportohet

1. **Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve** – Bashkia Durrës dorëzon raportimet periodike mbi gjenerimin, mbledhjen, riciklimin dhe depozitimin e mbetjeve. Të dhënat shërbejnë për përditësimin e Regjistrit Kombëtar të Mbetjeve dhe për raportimin kombëtar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.
2. **INSTAT** – një pjesë e të dhënave përfshihen në sistemin e statistikave kombëtare të mbetjeve, në përputhje me VKM nr. 687/2015 dhe kërkesat e Rregullores së BE nr. 2150/2002 “Për statistikat e mbetjeve”.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

3. **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)** – merr raportet vjetore të bashkive, të cilat shërbejnë për vlerësimin e përputhjes së PVMIM me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve (VKM nr. 418/2020).
4. **Këshilli Bashkiak dhe Publiku** – sipas parimeve të transparencës, Bashkia Durrës ka detyrim të publikojë raportin vjetor mbi menaxhimin e mbetjeve dhe progresin e PVMIM, duke e bërë të aksesueshëm për qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile.

Procedurat e Monitorimit

- **Objektivat**

- Matja e progresit të Bashkisë Durrës drejt objektivave të PVMIM dhe të Planit Kombëtar 2020–2035.
- Identifikimi i devijimeve dhe zbatimi i masave korrigjuese.

- **Indikatorët Kryesorë**

- Sasia totale e mbetjeve urbane (ton/vit; kg/banor).
- Përqindja e riciklimit dhe rikuperimit.
- Ndarja në burim dhe mbulimi i popullsisë me shërbim.
- Vëllimi i mbetjeve plastike dhe bio-mbetjeve.
- Sasia e mbetjeve të depozituara në landfill.
- Numri i pikave të paligjshme të depozitimit të evidentuara/eliminura.

- **Mekanizmat e Monitorimit**

- Inspektive mujore nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Inspektorati i Mjedisit të Bashkisë.
- Raportime tremujore nga operatorët e shërbimit të mbledhjes dhe transportit të mbetjeve.
- Regjistër elektronik i mbetjeve në bashki, i harmonizuar me sistemin kombëtar të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

- **Procedurat e Raportimit**

- Raport mujor i përmbledhur nga operatorët → Bashkia Durrës.
- Raport tremujor i Bashkisë Durrës → Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), përfshirë të dhënat mbi riciklimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin.
- Raport vjetor i integruar, në përputhje me VKM nr. 687/2015 dhe kërkesat e INSTAT, i cili publikohet për qytetarët dhe dërgohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

- **Procedurat e Verifikimit**

- Verifikim administrativ: Krahësimi i të dhënave të raportuara nga operatorët me inspektimet në terren.
- Audite të brendshme: Kryhen një herë në vit nga Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashki.
- Verifikim i jashtëm: Nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, si dhe auditime të mundshme nga institucionet e BE-së për përafrim me direktivat.
- Verifikim komunitar: Përmes publikimit të raporteve dhe konsultimeve me qytetarët dhe OJQ-të.

- **Cikli i MRV-së**

- Mbledhja e të dhënave nga operatorët dhe inspektimet.
- Raportimi periodik (mujor, tremujor, vjetor).
- Verifikimi dhe validimi i të dhënave.
- Publikimi dhe transparenca (faqja zyrtare e bashkisë, buletini vjetor).
- Përdorimi i rezultateve për përmirësimin e PVMIM dhe harmonizimin me objektivat e BE-së.

8. VEPRIMET STRATEGJIKE ME PËRPARËSI TË REKOMANDUARA (VSP)

8.1 Vështrim i përgjithshëm

Zbatimi i Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM) për Bashkinë Durrës kërkon përcaktimin e një seti veprimesh strategjike me përparësi (VSP), të cilat janë të orientuara drejt përmbushjes së objektivave kombëtare dhe lokale, si dhe përafrimit me acquis communautaire të Bashkimit Evropian. Këto veprime nuk janë vetëm masa të veçanta teknike, por përfaqësojnë një qasje të integruar, që lidh menaxhimin e mbetjeve me zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtjen e shëndetit publik dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit në territorin e Bashkisë Durrës.

Përparësitë strategjike janë përcaktuar mbi bazën e:

- analizës së gjendjes aktuale të menaxhimit të mbetjeve në territor, duke identifikuar boshllëqet dhe sfidat kryesore;
- legjislacionit kombëtar (Ligji nr. 10463/2011 dhe aktet nënligjore të lidhura me të) dhe dokumenteve kombëtare strategjike (Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve 2020–2035);
- direktivave dhe udhëzimeve të BE-së (p.sh. Direktiva 2008/98/EC për hierarkinë e mbetjeve, Direktiva 2019/904/EU për plastikën njëpërdorimshme);
- objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (SDG), veçanërisht SDG 11 (Qytete dhe komunitete të qëndrueshme) dhe SDG 12 (Konsum dhe prodhim të qëndrueshëm).

Në këtë kuadër, VSP-të për Bashkinë Durrës synojnë:

- forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e efikasitetit të shërbimit të mbledhjes e transportit;
- nxitjen e ndarjes në burim dhe rritjen e nivelit të riciklimit, në përputhje me objektivat kombëtare dhe të BE-së;
- reduktimin gradual të mbetjeve të depozituara në landfill dhe rritjen e rikuperimit të materialeve;
- forcimin e sistemit të monitorimit, raportimit dhe verifikimit (MRV) për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie;

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

- ndërgjegjësimin e komunitetit dhe edukimin mjedisor si bazë për ndryshim të qëndrueshëm të sjelljes;
- krijimin e partneriteteve të qëndrueshme me sektorin privat dhe organizatat e shoqërisë civile.

Ky grup veprimesh përfaqëson boshtin kryesor të zbatimit të PVMIM dhe është i ndërtuar në mënyrë që të sigurojë një tranzicion gradual të Bashkisë Durrës drejt një ekonomie qarkulluese dhe një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve.

8.2 Veprimet Strategjike me Përparësi

VSP 1 – Forcimi i shërbimit të mbledhjes dhe transportit të mbetjeve

Shërbimi i mbledhjes dhe transportit është hallka bazë e sistemit të menaxhimit të mbetjeve. Në Bashkinë Durrës sfidat kryesore lidhen me mbulimin jo të plotë të popullsisë, mungesën e frekuencës së rregullt në disa zona periferike dhe kapacitetet e kufizuara të operatorëve. Ky veprim parashikon: modernizimin e flotës së mjeteve, shtimin e kontejnerëve sipas fraksioneve, si dhe zgjerimin e mbulimit 100% të territorit të bashkisë me shërbim.

Në Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Durrës, ky veprim është shprehur si Objektivi Strategjik 2, i cituar më poshtë:

Objektivi Strategjik 2: Krijimi i një sistemi të unifikuar për grumbullimin e mbetjeve në të gjithë territorin e bashkisë, i mbështetur nga përmirësimi teknik dhe monitorimi i shërbimit, forcimi i kapaciteteve të punonjësve dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve, me synim parandalimin dhe ndarjen e mbetjeve në burim.

VSP 2 – Ndarja në burim dhe krijimi i infrastrukturës së riciklimit

Në përputhje me hierarkinë e mbetjeve (Direktiva 2008/98/EC), ky veprim ka për synim të vendosë në funksion sistemin e ndarjes në burim (plastikë, letër/karton, qelq, organike). Kjo përfshin ngritjen e pikave të grumbullimit të veçuar, vendosjen e kontejnerëve të diferencuar dhe nxitjen e ricikluesve privatë për të marrë pjesë aktivisht në zinxhirin e riciklimit.

Në Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Durrës, ky veprim është shprehur si Objektivi Strategjik 2 dhe 3, ku OS 3 citohet më poshtë:

Objektivi Strategjik 3: Ngritja dhe funksionimin i një sistemi të integruar rajonal në Zonën e Menaxhimit të Mbetjeve Tiranë – Durrës duke aplikuar parimet e ekonomisë qarkulluese...”

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

VSP 3 – Reduktimi i mbetjeve në landfill dhe zgjerimi i metodave alternative të trajtimit

Aktualisht një pjesë e madhe e mbetjeve urbane përfundon në landfill, çka nuk është në përputhje me objektivat kombëtare dhe evropiane. Ky veprim synon reduktimin gradual të mbetjeve që depozitohen në landfill përmes shtimit të kompostimit të bio-mbetjeve, zgjerimit të skemave të ripërdorimit dhe investimeve në impiante të trajtimit mekaniko-biologjik.

Në Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Durrës, ky veprim është shprehur si Objektivi Strategjik 2 dhe 3.

VSP 4 – Rehabilitimi i pikave të depozitimit të paligjshëm

Depozitimet informale të mbetjeve janë një problem i përsëritur në territorin e Bashkisë Durrës, me ndikim negativ në mjedis dhe shëndetin publik. Ky veprim përfshin hartëzimin e plotë të pikave të paligjshme, pastrimin e tyre dhe rehabilitimin me gjelbërim, duke vendosur një sistem monitorimi që parandalon riformimin e tyre.

Në Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Durrës, ky veprim është shprehur si Objektivi Strategjik 2 dhe 3.

VSP 5 – Forcimi i sistemit të monitorimit, raportimit dhe verifikimit (MRV)

Raportimi i rregullt është detyrim ligjor sipas Ligjit 10463/2011 dhe DCM nr. 687/2015. Ky veprim parashikon krijimin e një databaze elektronike në Bashkinë Durrës të lidhur me sistemin kombëtar të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, standardizimin e formularëve të raportimit për operatorët, si dhe trajnimin e stafit bashkiak në metodologjitë e BE-së për statistikat e mbetjeve.

VSP 6 – Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit

Menaxhimi i suksesshëm i mbetjeve nuk është vetëm një proces teknik, por kërkon ndryshim sjelljeje tek qytetarët. Ky veprim përfshin organizimin e fushatave të edukimit mjedisor në shkolla, aktivitete me komunitetin dhe promovimin e praktikave të reduktimit të mbetjeve (p.sh. përdorimi i produkteve të ripërdorshme, reduktimi i plastikës njëpërdorimshme).

VSP 7 – Zhvillimi i partneriteteve me sektorin privat dhe OJQ-të

Për të arritur objektivat e qarkullimit të materialeve, Bashkia Durrës duhet të krijojë mekanizma bashkëpunimi me sektorin privat (riciklues, operatorë turistikë, bizneset e HoReCa) dhe me organizatat e shoqërisë civile. Ky veprim përfshin nxitjen e skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (EPR), partneritete për fushata ndërgjegjësimi dhe mbështetje për projekte pilot të inovacionit në menaxhimin e mbetjeve.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

VSP 8 – Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe financiare

Për të zbatuar me sukses PVMIM, Bashkia Durrës duhet të përmirësojë kapacitetet e saj institucionale dhe burimet financiare. Ky veprim përfshin trajnime për stafin bashkiak, rritjen e eficiencës në mbledhjen e tarifës së pastrimit, si dhe aksesimin e fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare (IPA III, programe të BE-së për ekonominë qarkulluese).

9. INFORMACION MBI PROCEDURËN E KONSULTIMIT PUBLIK

9.1 KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT PËR ÇËSHTJET QË DO TË TRAJTOHEN NË RAPORTIN E VSM-SË

Referuar dispozitave të ligjit nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor” Bashkia Durrës ka zhvilluar procesin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe ka përmbushur fazën e konsultimit me grupet e interesit për çështjet që do të trajtohen në raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, sikurse parashikohet në nenin 9 të këtij ligji dhe në kreun II të VKM nr. 219, datë 11.03.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”.

Qëllimi i fazës së parë të konsultimit ishte arritja e një marrëveshjeje me palët përkatëse të interesit lidhur me çështjet që do të trajtohen në raportin paraprak të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

Më datë 10.07.2025, ora 10:30, në ambjentet e Bashkisë Durrës u zhvillua procedura e konsultimit me grupet e interesit për çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së, për Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Durrës.

Sikurse përcaktohet në nenin 9 të Ligjit nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, procedura e konsultimit me grupet e interesit kërkohet të përmbushet gjatë disa fazave të VSM-së. Qëllimi i fazës së parë të konsultimit ishte arritja e një marrëveshjeje me palët përkatëse të interesit lidhur me çështjet që do të trajtohen në raportin paraprak të VSM-së, i cili do të përgatitet në kuadër të miratimit të Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Durrës.

Në takim ishin të pranishëm përfaqësues nga institucionet e renditura më poshtë:

- Bashkia Durrës;
- Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës;
- Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës;
- Qendra “Durrësi Aktiv”;
- Shoqata “Udhëtimi i lirë”.

Në vijim paraqitet një përmbledhje e zhvillimit të konsultimit me grupet e interesit për çështjet që do të trajtohen në raportin paraprak të VSM-së dhe gjithashtu listëprezenca e palëve të pranishme:

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Nr.	Zhvillimi	Personi përgjegjës	Komente
1.	Mirëseardhja dhe qëllimi i takimit	Konsulenti mjedisor	Fillimisht iu urua mirëseardhja palëve të pranishme në takim dhe gjithashtu iu bë me dije se qëllimi i konsultimit në këtë fazë të VSM-së është përcaktimi i çështjeve që do të trajtohen në këtë raport, për të cilin kontributi nga palët e interesuara është i mirëpritur.
2.	Prezantimi i qëllimit dhe objektivave të Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Durrës	Konsulenti mjedisor	Shkurtimisht u prezantuan disa informacione bazë të Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Durrës, si qëllimi, objektivat, gjendja aktuale e infrastrukturës së grumbullimit e transportimit të mbetjeve, të dhënat demografike.
3.	Prezantimi i procesit të VSM që do të ndiqet dhe i çështjeve që propozohen të shqyrtohen gjatë hartimit të VSM	Konsulenti mjedisor	U shpjeguan hapat që do të ndiqen për finalizimin e VSM-së dhe fazat e konsultimit me grupet e interesit që janë të nevojshme për realizimin e raportit të VSM-së. Gjithashtu pjesëmarrësit u vendosën në dijeni se institucionit vendimmarrës (Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit) i është nisur shkresa për njoftimin për fillimin e procedurës.
4.	Pyetje dhe diskutime		Pas përfundimit të prezantimit nga Konsulenti, u la hapësirë për pyetje nga palët e interesuara. Një përmbledhje e diskutimit të zhvilluar jepet më poshtë: - Nga znj. Laura Gjyli, pedagoge në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, u ngritën një sërë shqetësimesh, si: - Ndërgjegjësimi i qytetarëve, veçanërisht grupmoshave të rritura, pasi janë më pak të predispozura të reflektojnë mbi menaxhimin e mbetjeve;

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Nr.	Zhvillimi	Personi përgjegjës	Komente
			- Ndotja që vjen nga lumi Ishëm nga Bashkia Tiranë, e cila përcillet në grykëderdhjen e lumit dhe është shqetësuese për komunitetin pasi përmban mbetje të ngurta (kryesisht plastikë), ujëra të zeza etj., duke rritur nivelin e ndotjes së mjedisit në tërësi e ujërave sipërfaqësore në veçanti. Znj. Gjyli sugjeroi që ndotja që vjen nga rrjedhat e sipërme të lumenjve Ishëm e Erzen është një çështje që duhet të adresohet në raportin e VSM. 2. Nga znj. Trikshiqi u parashtrua për diskutim çështja lidhur me distancën e koshave nga shtëpitë e banimit dhe fakti që nuk ekziston një kuadër ligjor i përditësuar, në korrelacion me rritjen e popullsisë. U sugjerua që në raportin e VSM të shqyrtohet ndikimi kumulativ me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Durrës, me fokus në largësinë e koshave nga zonat e banuara, si dhe zhurmat e ndotja e ajrit që shkaktohen nga mjetet e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve. Nisur nga çështjet që u diskutuan, tematikat të cilat do të kenë një rëndësi domethënëse gjatë hartimit të raportit të VSM, janë: - Ndikimi i zbatimit të planit në ujërat sipërfaqësore, duke qenë se Durrësi është qytet bregdetar dhe në vijën bregdetare të tij ndodhen deltat e lumenjve Ishëm, Erzen; - Ndikimi i infrastrukturës (koshat dhe mjetet) e grumbullimit e transferimit të mbetjeve në shëndetin publik dhe nivelin e zhurmës për komunitetin; - Ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe bizneseve lidhur me menaxhimin e mbetjeve. Në mbyllje të konsultimit paraprak të VSM-së, palët e interesuara u njoftuan se brenda një afati kohor dy javor mund të dërgojnë sugjerimet e tyre lidhur me çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së në formë shkresore ose me e-mail.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Listë-prezenca e grupeve të interesit të pranishëm:

PROCES VERBAL I DEGJESES PUBLIKE PER PROJEKTIN: MBROJTJA E MJEDISIT NËPËRMJET MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE
DATE: 10.07.2025

NR	EMER MBIEMER	POZICIONI PUNES	INSTITUCIONI	E-MAIL	NR. TEL	FIRMA
1	DORJANA LAZI	SPECIALIST	B. Durrës / shk. mjed	Dorjana.lazi@durres.gov.al	069437080	
2	KLAUDIA HYSENI	Dejta Elzakufi	Drejtoresha Durrës Pkri	klaudia.2008@hotmail.com	0652836385	
3	Ivon Pentafi	Shk. mjedisi	ESDO	ivon.pentafi@esdo.al	0684676748	
4	Greta Hala	Ing. mjedisi	ESDO	esdo@esdo.al	0686232439	
5	Ornela Shoshi	Konsilante mjedisore	ESDO	info@esdo.al	0698137888	
6	Ejina Demalija	Koordinatorë	Shoqata "Udhëtim i lirë"	udhetimilire@gmail.com	0698573870	
7	Ety Koni	SPECIALIST	MSHK DURRE	ety.koni@gmail.com	0695155686	
8	Laura Gjyfi	pedagogje	U.A.M.D	lauragjyfi@uam.dedu.al	0682446788	
9						
10	Rudina Tushaj	perpjegje mjedisore	B. Durrës	rudina.tushaj@durres.gov.al		
11	FLORENTA KERTUBERT	Pajpa Selektor	B. Durrës	florinda.kertubert@durres.gov.al	06+530545776	
12	Ervin Kullelli	Pajpa Selektor	MSHK	ervin.kullelli1985@gmail.com	0697050540	
13						
14						
15						
16						
17						
18						
19						
20						
21						
22						
23						
24						
25						

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Foto gjatë zhvillimit të konsultimit me publikun për sa i përket çështjeve që do të trajtohen në raportin e VSM-së



Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës



Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Prezantimi i mbajtur gjatë konsultimit jepet në vijim:



KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT PËR ÇËSHTJET QË DO TË TRAJTOHEN NË RAPORTIN E VSM-së (SCOPING)

Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Durrës

IADSA II/2023/15

Datë: 10.07.2025, Durrës.



QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE BASHKIA DURRËS

Projekti synon të **fuqizojë Bashkinë Durrës** në **mbrojtjen efektive të mjedisit** dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve urbane. Përmes zbatimit të **metodave inovative** dhe **përfshirjes aktive të aktorëve lokalë**, ai do të ndihmojë bashkinë të përmbushë detyrimet e saj, siç përcaktohet në Dokumentin e Politikave Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2022-2035, Planin Sektorial Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta dhe politikat kombëtare për mjedisin.

Objektivat specifike të projektit:

- **Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve** në Bashkinë Durrës përmes një planifikimi të mirëstrukturuar dhe gjithëpërfshirës.
- **Stimulimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit**, duke promovuar reduktimin e mbetjeve, optimizimin e kostove dhe përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve.
- **Fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve** për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve e iniciativave të përbashkëta.
- **Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik**, duke përfshirë qytetarët, studentët dhe institucionet publike në çështjet e menaxhimit të mbetjeve dhe masat për reduktimin e tyre.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Përse Hartohet Plani?

Plani, ka për qëllim që ti japë bashkisë Durrës një instrument solid që do të sigurojë menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Bashkiake:

- **Përputhshmëri me Dokumentin e Politikave Strategjike** të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Planin Kombëtar 2020–2035" (Dokumenti i Politikave Strategjike) dhe "**Plani Sektorial Kombëtar** për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta" (Plani Sektorial) Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 27.05.2020.
- **Përbushjen e opsioneve** më të mira të mundëshme për **grumbullimin dhe transportin** e MNB duke marrë në konsideratë **infrastrukturën vendore dhe rajonale**.
- **Përbushjen e opsioneve të reduktimit** të mbetjeve nëpërmjet **riciklimit dhe kompostimit** për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare.
- **Përbushjen e nevojave financiare** operacionale dhe investimeve kapitale për zbatimin e skemave të grumbullimit, transportit dhe trajtimit të mbetjeve.

Kuadri ligjor dhe institucional i shërbimit

Institucionet përgjegjëse

- **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe aspekteve të përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve.
- **Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve** e cila mundëson tranzicionin nga një qasje linare në atë qarkulluese në sektorin e menaxhimit të mbetjeve.
- **Agjencia Kombëtare e Mjedisit** ushtron kompetencat e saj në mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe analizimin e të dhënave për krijimin dhe trajtimin e mbetjeve të cilat lidhen me zbatimin e lejeve mjedisore

Legjislacioni kryesor

- Aktualisht, **ligji 10,463 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i amenduar**, është legjislacioni bazë që përcakton përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe vendore në fushën e menaxhimit të mbetjeve.
- **Në Shtator të 2024 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** ka shpalluar për konsultim publik **ligjin e ri** për menaxhimin e integruar të mbetjeve duke përfshirë ndarjen e vendit në **10 zona mbetjesh**.
- **Ligji 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"** përcakton përgjegjësitë e NJQV-ve ku "grumbullimi, transportimi, asgjësimi dhe trajtimi i mbetjeve ngurta urbane" është përcaktuar si një funksion "i veti" i bashkive.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Të dhëna demografike

Numri i banorëve			
Njësitë Administrative	Popullsia INSTAT 2023	Popullsia RGJC 2024	Popullsia formula e Ministrisë së Financave
Durrës	101,728	234,854	141,666
Sukth	13,395	31,321	18,773
Ishëm	3,683	9,602	5,459
Katundi i ri	7,524	17,180	10,421
Rrashbull	20,099	37,837	25,420
Manëz	7,185	12,764	8,859
Total	153,614	343,558	214,503

Nj. Adm. Durrës ka 234,854 banorë ose rreth 68% e popullsisë së bashkisë;
 Nj. Adm. Rrashbull ka 37,837 banorë ose 11% e totalit të popullsisë;
Nj. Adm. Ishëm ka 9,602 banorë ose 3% e totalit të popullsisë

Nj.A. Durrës me rreth 5,871 banorë për km² i cili ka një diferencë të madhe në raport me Nj.A. Ishëm e cila ka një dendësi prej 114 banorësh për km²

Turizmi ditor i vlerësuar: 2,739 ditë;

Nr. total i vlerësuar i turistëve: **1 million.**

Gjendja e shërbimit


Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës, NSHKD ofron shërbim në Nj. A. Durrës, Katund i Ri dhe Manëz.

AFA Group Shpk është kompani nënkontraktore e cila ofron shërbim në Nj.A. Sukth dhe Ishëm; Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Plazh, NSHKP ofron shërbim në Nj.A. Durrës, Rajoni 5 dhe Rrashbull.

Bashkia Durrës ka në pronësi **1,859 kontejner** ku një pjesë e tyre janë plastik dhe të përshtatshëm për ndarjen e mbetjeve në burim ndërsa pjesa tjetër e tyre kryesisht kontejner metalik

Bashkia Durrës	Kontejner
Durres	1085
Sukth	221
Ishëm	109
Katundi i ri	81
Rrashbull	282
Manëz	81
Total	1859

Numri i banorëve për kontejner



Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

Mjetet

NSHKD ka në pronësi të saj 21 mjete të cilat 8 prej tyre janë të tipit agregat/të mbyllur dhe 13 janë kamionçna të hapura. Mjete kanë kapacitetet të ndryshme të cilat varrojnë nga 3.5 në 16 ton dhe pjesa më e madhe e tyre kanë më shumë se 10 vite punë me një moshë mesatare prej 22 vitesh punë.

Ndërsa NSHKP ka në pronësi të saj 20 mjete të cilat 6 prej tyre janë të tipit agregat/të mbyllur dhe pjesa tjetër janë mjete të hapura. Mjetet janë në kapacitetet të ndryshme mbajtëse të cilat varrojnë nga 0.7 në 12 ton dhe pjesa më e madhe e tyre kanë më shumë se 10 vite punë, flota e mjeteve të NSHKP ka një moshë mesatare prej 20 vitesh.



Popullsia që merr shërbim

Tipi i të dhënave	Vlera
Numri i popullsisë që merr shërbim	343,558
% popullsisë që merr shërbim	100%
Sasia e mbetjeve të gjeneruara (e vlerësuar)	67,094
Sasia e mbetjeve të mbledhura (ton/vit)	67,094
Mbetje të gjeneruara (kg/banorë/ditë)	0.54 kg/banorë/ditë
Frekuenca e mbledhjes së mbetjeve në secilën nga zonat e shërbimit	
a. Zona 1 (Urbane)	10 herë/javë
b. Zona 2 (Rurale)	7 herë/javë

	NKSHD	NKP	AFA Group	Total
Numri i itinerareve	20*	7	3	30*
Numri i konteniereve	935	666	330	1,841
Numri i pikave*	304	235	179	718

- 1 itinerar në Nj.A. Durrës nuk është kryer për shkak se një nga mjetet është jashtë funksionit

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës


VSM DHE RËNDËSIA E TIJ

Vlerësimi Strategjik Mjedisor – VSM është një proces **sistematik** që **vlerëson pasojat në mjedis** të një plani ose programi të propozuar për zbatim me qëllim që të sigurojë që këto pasoja mjedisore të adresohen plotësisht që në fazat e hershme të vendimmarrjes përkrah konsideratave ekonomike dhe sociale.

- Gjatë procesit të VSM **identifikohen zonat me rëndësi dhe përparësi mjedisore duke u bërë kriter planifikues** ato janë shpëtuar nga dëmtime të pakthyeshme dhe shtruese (si rrjeti i burimeve ujore dhe distancat që duhet të ruhen për ndërtimet pranë tyre);
- I zhvilluar që në fazat e hershme të planifikimit VSM **mundëson të analizohet një gamë më të gjërë alternativash duke i dhënë mjedisit me shumë shanse të ruajë cilësitë e tij**. Nëse planifikimi realizohet pa proces VSM atëherë kriteret mjedisore mund të jenë të cunguara edhe për shkak të mos përfshirjes së ekspertëve të mjedisit;



FAZAT KRYESORE TE VSM BAZUAR MBI PRAKTIKAT NDERKOMBETARE



Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

FAZAT E PROCESIT TË VSM SIPAS LEGJISLACIONIT NË SHQIPËRI

- a. **njoftimi i ministrisë** nga autoriteti propozues (screening); ✓
- b. **konsultimi me grupet e interesit** për çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së (scoping); **On going**
- c. **hartimi i raportit paraprak** e **konsultimi me grupet e interesit** dhe publikun i **raportit paraprak të VSM-së** (dokumentat/raporti);
- d. **hartimi i raportit përfundimtar** të vlerësimit strategjik mjedisor (dokumentat/raporti & konsultimi);
- e. **shqyrtimi i propozimit** dhe **deklarata e ministrit** (konsultimi & vendim-marrja);
- f. **vendimi i autoritetit miratues** (vendim-marrja); **KQ**
KM
- g. **monitorimi**.

QËLLIMI

- ✓ Të përcaktojë çështjet kryesore që do të trajtohen në mënyrë specifike në raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor,
- ✓ Të argumentojë se cilat mund të jenë çështjet mjedisore që nuk është e nevojshme të trajtohen me detaje dhe që nuk është e nevojshme të përfshihen në analizë të mëtejshme.



Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

SCOPING

Faza e konsultimit me grupet e interesit për çështjet që do trajtohen në raportin e VSM-së (scoping) renditet e dyta gjatë fazave të procedurës së Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

➤ Kjo fazë ka rëndësi të veçantë për fazën pasardhëse, e cila është hartimi i raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.



Gjatë kësaj faze, duhet të përshkruhen paraprakisht:

- ✓ alternativat e mundshme ose opsionet të cilat duhet të adresohen në kuadër të VSM-së;
- ✓ dimensionet territoriale të ndikimeve të mundshme;
- ✓ analiza dhe sondazhe që do të kryhen, si dhe metodat dhe mjetet që do të përdoren;
- ✓ Palët e interesuara që do të jenë të përfshira (duke përfshirë autoritetet mjedisore dhe shëndetësore, si dhe publikun), si dhe nivelin dhe natyrën e përfshirjes së tyre në procedurën e VSM-së.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

- ✓ **Çështjet e identifikuara në këtë fazë** të konsultimit, **adresojnë vlerësimin bazë të mjedisit**, vlerësimin aktual të ndikimeve të mundshme dhe do të mbajë në konsideratë alternativa ose opsione të mundshme, prandaj është dhe një hap kyç për një VSM efikas.
- ✓ **Qëllimi i përcaktuar mirë i vlerësimit** mundëson mbajtjen e VSM-së të fokusuar në problemet kyçe dhe kështu minimizon kërkesat personale dhe kohën.
- ✓ **Jo të gjitha aspektet mjedisore duhet të adresohen në çdo vlerësim** - nga ana tjetër, VSM-ja mund të konsiderojë përfshirjen e temave më të gjëra mjedisore ose sociale p.sh. përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, mundësitë e punësimit etj.

Kjo fazë konsultimi ndihmon:

- (i) **për të identifikuar lidhjet midis planit/ programit të vlerësuar me të dokumente të tjera strategjike;**
- (ii) për të mbështetur zgjedhjen e çështjeve kyçe (pra, nëse ka objektiva të përcaktuara në dokumenta zyrtar të miratuar, kjo do të thotë se janë të rëndësishme dhe duhet të adresohen në VSM).

Cross cutting issues




Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Durrës

**EVEN AN EXCELENT PLAN CAN STILL
HAVE NEGATIVE CUMULATIVE EFFECTS**

WITH OTHER PLANS!



**Faleminderit
për
pjesëmarrjen aktive!**